



Udhëzimi, kriteret dhe masat mbështetëse nga Skema Kombëtare e Investimeve 2024

Faqe 11-15

Diagnoza - Pse mungon skema e sigurimit në bujqësi? - Rrapaj: Përgjegjësia bie mbi 4 aktorë. Guri: Nuk është luks, por domosdoshmëri

Faqe 7

Skemë turke për sigurimin e bujqësisë shqiptare. Çfarë është TARSIM dhe si funksionon ai? Primet i mbulon shteti

Faqe 4



AGROBIZNESI

FED invest

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i parë i muajit tetor 2024 **Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 495** Çmimi 125 lekë E përdyjavshme e pavarur

GLOBALG.A.P DHE PRAKTIKAT E MIRA BUJQËSORE, ÇELËSI PËR EKSPORTET DHE RRITJEN E TREGJEVE NDËRKOMBËTARE

RRITJA E KAPACITETEVE TË CERTIFIKIMIT DHE AKREDITIMIT, NJË SHTYLLË PËR SUKSESIN E EKSPORTUESVE SHQIPTARË

UNIDO në bashkëpunim me SECO nëpërmjet projektit GQSP Albania po mbështesin Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit (DPA) në rritjen e kapaciteteve të saj për certifikimin sipas standardit ISO/IEC 17065 dhe GLOBALG.A.P, me qëllim të zbutjes së varësisë nga trupat certifikuese të huaja dhe lehtësimin e certifikimit brenda vendit

GLOBAL QUALITY AND STANDARDS PROGRAMME | **ALBANIA**

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

UNIDO
UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



Shqipëria hap negociatat me BE-në për grup-kapitullin e "Themeloreve"

Faqe 2

UNIDO

Forumi Rajonal 2024 nis në Shkodër me trajnimet e fermerëve dhe NVM-ve në Reç për standardin GLOBALGAP

Faqe 2

FINANCIM

- Qeveria gjermane, 93.39 mln euro për Shqipërinë - Fokus i bashkëpunimit 2025-2026, zhvillimi i sektorëve prioritarë

Faqe 2

- TEMA TË DITËS**
- Agroturizmet, qendra ekonomike që nxisin zinxhirin e prodhimit në zonat rurale Fq.4
 - Fasulja në Kukës shitet 500-600 lekë për kg, konsumatorët: Çmimi është i lartë Fq.5
 - Dita Ndërkombëtare e Grave Rurale, historia e Dritës që vazhdon traditën e tezgjahut Fq.5
 - BERZH dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania nxisin investimet e gjelbra në sektorin rezidencial të Shqipërisë Fq.7
 - Mjedis - BE pritet të ndalojë pirjen e duhanit edhe në ambiente të jashtme Fq.10

FAO

Është koha për ta kthyer në realitet "Të Drejtën për Ushqime" për një dietë të shëndetshme, ushqyese dhe të përballueshme

Faqe 6

TEMA TË DITËS

Forumi Rajonal 2024 nis në Shkodër me trajnimet e fermerëve dhe NVM-ve në Reç për standardin GLOBALGAP

Forumi Rajonal 2024 nis në Shkodër me trajnimet e fermerëve dhe NVM-ve në Reç për standardin GLOBALGAP!

Përfaqësues nga DPA-Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, Drejtori i Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Shkodër dhe specialistët nga Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) që ofrojnë mbështetje dhe ekspertizë për fermerët në rajon dhanë një kontribut të vyer gjatë takimit.

Përmes forumit rajonal dhe trajnimeve, synojmë të përmirësojmë standardet e prodhimit bujqësor nga fermerët e bimëve aromatike mjekësore me synimin që të arrijnë nivele të larta të sigurisë ushqimore dhe cilësisë së produkteve, duke hapur mundësi të reja për tregjet ndërkombëtare që kërkojnë produkte të certifikuar.

Fermerët gjithashtu po marrin njohuri për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për procesin e certifikimit GLOBALGAP, duke i bërë më të aftë për të kaluar me sukses këtë proces.

Fermerët do të:

të tyre.

- Ulin kostot përmes praktikave më të mira.

- Sigurojnë akses në tregje të reja falë certifikimit GLOBALGAP.

- Rrisin përfitimet ekonomike dhe qëndrueshmërinë e

biznesit të tyre.

Forumi rajonal dhe trajnimet për standardin GLOBALGAP mbështetet nga UNIDO dhe SECO, me synim forcimin e SME-ve dhe përmirësimin e qasjes së tyre në tregjet më të kërkuara!



Qeveria gjermane, 93.39 mln euro për Shqipërinë - Fokus i bashkëpunimit 2025-2026, zhvillimi i sektorëve prioritarë

Në Berlin është nënshkruar Protokollin e Bashkëpunimit me Gjermaninë për vitet 2025-2026, me fokus në fushën e bashkëpunimit ekonomik dhe në zhvillimin e sektorëve prioritarë të qeverisë shqiptare.

Sipas njoftimit zyrtar nga Ambasada gjermane në Tiranë thuhet se ky protokoll parashikon një mbështetje financiare për qeverinë shqiptare në vlerën prej 93.39 milionë euro (nga këto 33.39 milionë € grante, 60 milionë € kredi me interes të ulët).

Mbështetja financiare do të

jetë për një gamë të gjerë sektorësh si në: energji, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, arsimin profesional, bujqësinë, si dhe mbështetjen në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Ambasada gjermane në Tiranë thekson se me nënshkrimin e këtij protokoll është hedhur një tjetër gur kilometrik në bashkëpunimin tonë 36-vjeçar gjermano-shqiptar.

"Pas 2,5 ditësh bisedimesh dhe negociatash intensive, drejtuesit e delegacioneve, përbërë secila prej rreth 10 anëtarësh, nënshkruan sot një

plan të përbashkët pune për vitet 2025/2026 në fushën e bashkëpunimit ekonomik", thuhet në njoftim.

Ndërkaq, Ambasada gjermane u shpreh se në këto kohë të vështira dhe me buxhete të kufizuara, Gjermania ka rritur mbështetjen e saj për Shqipërinë në krahasim me vitet e shkuara.

Me këtë duam të japim një mesazh të qartë: Ne vlerësojmë përparimet në reforma të vendit dhe i qëndrojmë në krahasim partnerëve tanë me vlerë në procesin e anëtarësimit në BE!



QEVERIA GJERMANE, 93.39 MLN EURO PËR SHQIPËRINË
FOKUS I BASHKËPUNIMIT 2025-2026, ZHVILLIMI I SEKTORËVE PRIORITARË

Shqipëria hap negociatat me BE-në për grup-kapitullin e "Themeloreve"

Në Luksemburg u mbajt Konferenca e Dytë Ndërqeveritare mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian.

cilët përfaqësojnë sektorët e kapitujve të negociatave që do të hapen ditën e nesërme, të njohura si "Themeloret".

financiar


Pas prezantimit të metodologjisë së rishikuar për negociatat e anëtarësimit në vitin 2020, kapitujt negociues ndahen në gjashtë grupe tematike: Themeloret; Tregu i brendshëm; Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse; Axhenda e gjelbër dhe lidhja e qëndrueshme; Burimet, bujqësia dhe kohezioni; dhe marrëdhëniet me jashtë.

Negociatat për grup-kapitullin 1 hapen të parat dhe mbyllen të fundit. Progresi në këtë grup do të përcaktojë ritmin e përgjithshëm të negociatave.

Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm (Coreper II) miratoi qëndrimin e përbashkët të BE-së duke hapur grupin e parë të negociatave me Shqipërinë, duke lejuar kështu mbajtjen e një konference ndërqeveritare me Shqipërinë më 15 tetor 2024 në Luksemburg.

Shqipëria do të jetë e para ndër vendet candidate që do të hapë negociatat e anëtarësimit sipas metodologjisë së rishikuar të zgjerimit, e cila do të jetë një moment kyç për vendin e Ballkanit Perëndimor.

Grupi i parë i kapitujve mbulon reformat themelore, duke i hapur rrugën fillimit të negociatave për grupe të tjera. Progresi në këto reforma do të përcaktojë gjithashtu ritmin e përgjithshëm të negociatave.



Takimi do të drejtohet nga kryeministri Edi Rama dhe ministri hungarez i Punëve të Jashtme dhe Tregtisë, Péter Szijjártó, vend i cili mban Presidencën e radhës së BE-së. Pas takimit, rreth orës 09:25 pritet një konferencë për shtyp e kryeministrit Edi Rama dhe ministrit Hungarez të Punëve të Jashtme dhe Tregtisë, Péter Szijjártó.

Shqipëria përfaqësohet në këtë konferencë nga Kryeministri Edi Rama, Kryenegociatorja Majlinda Duka si dhe ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani. Në tryezë për palët shqiptare janë edhe të gjithë zv/ministrat, të

Takimi do të shërbejë për hapjen e negociatave me Shqipërinë për grup-kapitullin 1, që përfshin fushat dhe kapitujt e negociatave si:

Funksionimi i institucioneve demokratike dhe reforma e administratës publike
Kapitulli 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Kapitulli 24 - Drejtësia, liria dhe siguria

Kriteret ekonomike
Kapitulli 5 - Prokurimi publik
Kapitulli 18 - Statistikat
Kapitulli 32 - Kontrolli

Jole: Rreth 20 mijë fermerë kultivojnë mollë në qarkun e Korçës

Molla është një nga produktet identifikuese të prodhimit bujqësor në qarkun e Korçës, ku sipërfaqja e mbjellë me të është rreth 4000 ha.

Prefekti i qarkut të Korçës, Nertil Jole tha se "janë rreth 8000 familje që merren me kultivimin e mollës, ose rreth

cili disponon një frigorifer me kapacitet 200 tonë".

"Ai ka grumbulluar varietetet e mollëve (Gold, Starking, Fuji dhe Granny Smith) nga fermerët e zonës, duke siguruar edhe kontratat për shitjen e tyre në tregun vendas", tha Jole.

bashkinë Devoll, Lisandër Çuko biseduan me Irjat Ibo, i cili u shpreh i kënaqur nga prodhimi i sivjetshëm dhe vit pas viti kërkon e vlerëson mundësitë për të ulur kostot e mirëmbajtjes e të magazinimit, për të rritur më shumë fitimin për aktivitetin e tij si grumbullues.

"Bashkimi i fermerëve shkon mundësitë e mbështetjeve më të plota nga skema kombëtare dhe grantet e BE-së, përmirëson cilësinë e prodhimit dhe rrit të ardhurave", tha Jole.

Në Shqipëri dy janë zonat që regjistrojnë prodhimin më të lartë të mollëve në vend: Korça dhe Dibra. Varietetet që prodhohen më së shumti në vend janë dy derivatet e Red Chief dhe Starking, që përbëjnë 52% të pemëve drurëve frutore dhe Golden Delicious që përbëjnë 42%.

Varietetet e tjera të mollëve përbëjnë 6% të pemëve të tjera frutore. Këtu përfshihen dhe lloje të tjera, që nuk janë të varieteteve tradicionale rritur në rajon, si "Gala", "Mutsu" dhe "Granny Smith".



20 mijë fermerë".

Teksa zhvilloi një vizitë në pikën e grumbullimit të Irjat Ibos, në fshatin Vranisht të bashkisë Devoll, Jole tha se "Ibo është një nga grumbulluesit më të njohur të zonës, i

Prefekti Jole së bashku me Ylver Bylykbashin, një agronom me përvojë shumë të gjatë në fushën e pemëtarisë e frutave (sidomos mollëve), nënprefektin Henrik Rusi dhe Drejtorin e Bujqësisë në

GLOBALG.A.P DHE PRAKTIKAT E MIRA BUJQËSORE, ÇELËSI PËR EKSPORTET DHE RITJEN E TREGJEVE NDËRKOMBËTARE

RRITJA E KAPACITETEVE TË CERTIFIKIMIT DHE AKREDITIMIT, NJË SHTYLLË PËR SUKSESIN E EKSPORTUESVE SHQIPTARË

UNIDO në bashkëpunim me SECO nëpërmjet projektit GQSP Albania po mbështesin Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit (DPA) në rritjen e kapaciteteve të saj për certifikimin sipas standardit ISO/IEC 17065 dhe GLOBALG.A.P, me qëllim të zbutjes së varësisë nga trupat certifikuese të huaja dhe lehtësimin e certifikimit brenda vendit

Certifikimi i produkteve bujqësore ka një rol të rëndësishëm në përmirësimin e konkurrencës së produkteve shqiptare në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Për të përmbushur kërkesat e blerësve dhe standardet ndërkombëtare, produktet bujqësore duhet të kalojnë nëpër një proces të rreptë certifikimi. Në sektorin e Bimëve Aromatike dhe Mjekësore (BAM) dhe Frutave dhe Perimeve (FP), certifikimi GLOBALG.A.P është bërë gjithnjë e më i kërkuar për të siguruar që produktet plotësojnë standardet globale për sigurinë ushqimore dhe qëndrueshmërinë mjedisore.

Certifikimi i produkteve, veçanërisht për sektorët bujqësorë, nuk është thjesht një kërkesë teknike për të hyrë në tregjet ndërkombëtare, është një domosdoshmëri strategjike për ndërtimin e marrëdhënieve tregtare afatgjata dhe të qëndrueshme me partnerët globalë. GLOBALG.A.P dhe standarde të tjera ndërkombëtare sigurojnë që produktet shqiptare të përmbushin kërkesat strikte për sigurinë ushqimore, gjurmueshmërinë dhe qëndrueshmërinë mjedisore. Të gjitha këto janë kritike për të fituar besimin e konsumatorëve dhe për të krijuar një reputacion të fortë në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare.

Për më tepër, certifikimi i akredituar rrit besimin midis blerësve dhe partnerëve tregtarë ndërkombëtarë, të cilët kërkojnë që produktet që importojnë të jenë në përputhje me standardet globale të cilësisë dhe sigurisë. Në një treg gjithnjë e më të integruar, ku kërkesat për transparencë dhe përgjegjësi po rriten, certifikimi i produkteve përbën një kartë kalimi të rëndësishme për tregjet e reja dhe mund të jetë një faktor kyç për krijimin e marrëveshjeve afatgjata me importuesit ndërkombëtarë.

Në mungesë të certifikimit të akredituar brenda vendit, fermerët dhe bizneset bujqësore shqiptare përbalen me vështirësi logjistike dhe kosto shtesë për të marrë këto certifikime jashtë vendit, gjë që ngadalëson procesin e eksportit dhe rrit barrën financiare. Akreditimi vendor i trupave certifikuese sipas standardit ISO/IEC 17065 dhe GLOBALG.A.P do të lehtësojë këtë proces, duke u dhënë fermerëve mundësinë të certifikohen më shpejt dhe më lehtë dhe njëkohësisht duke përforcuar besueshmërinë e produkteve të tyre.

Një certifikim i tillë i njohur ndërkombëtarisht jo vetëm që siguron qasje në tregje të reja, por gjithashtu ndihmon në krijimin e marrëdhënieve afatgjata me partnerët tregtarë globalë, të cilët shpesh preferojnë të bashkëpunojnë me furnizues që kanë një reputacion të besueshëm për përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare. Ky element strategjik është një faktor kyç për të rritur eksportet e qëndrueshme dhe për të siguruar rritje ekonomike afatgjatë në sektorin bujqësor shqiptar.

Sfidat dhe Perspektivat për Certifikimin e Produkteve në Shqipëri

Sigurimi i certifikimeve për produktet bujqësore në Shqipëri paraqet sfida për fermerët dhe bizneset bujqësore, për shkak të mungesës së njohjes ndërkombëtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (DPA) për skema të rëndësishme si GLOBALG.A.P. Aktualisht, trupat certifikuese shqiptare duhet të marrin akreditimet jashtë vendit, çka rrit koston dhe ndërlikon procesin logjistik për fermerët dhe NVM-të që synojnë eksportin në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare. GLOBALG.A.P është një standard kritik që garanton përmbushjen e kërkesave për sigurinë ushqimore dhe gjurmueshmërinë – elemente thelbësore për akses në tregjet e huaja.

UNIDO dhe projekti GQSP Albania po mbështesin Drej-

torinë e Përgjithshme të Akreditimit (DPA) në rritjen e kapaciteteve të saj për certifikimin sipas standardit ISO/IEC 17065 dhe GLOBALG.A.P, me qëllim të zbutjes së varësisë nga trupat certifikuese të huaja dhe lehtësimin e certifikimit brenda vendit. Kjo iniciativë do të ulë koston për fermerët, do të thjeshtojë procesin e certifikimit dhe do të përmirësojë mundësitë e eksporteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare.

Për më shumë informacion mbi trupat certifikuese të miratuara dhe detajet për certifikimet, ju lutemi vizitoni faqen zyrtare të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Forcimi i Kapaciteteve të Certifikimit për Produktet - Trajnimi mbi ISO/IEC 17065 në Shqipëri

Një komponent thelbësor për përmirësimin e kapaciteteve të certifikimit të produkteve në Shqipëri ishte organizimi i një trajnimi treditur mbi standardin ndërkombëtar ISO/IEC 17065:2012, organizuar nga UNIDO dhe SECO në kuadër të projektit GQSP Albania. Ky trajnim, i mbajtur më 7-9 Tetor 2024, synonte forcimin e kapaciteteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (DPA) për të kuptuar dhe zbatuar kërkesat e këtij standardi, i cili përcakton kriteret për kompetencën e trupave certifikuese të produkteve.



Pjesëmarrësit, përfshirë stafin teknik dhe drejtues të DPA-së dhe anëtarët e komiteve të certifikimit, përfituan njohuri të avancuara mbi ISO/IEC 17065, duke përfshirë procesin e certifikimit të produkteve, vlerësimin e konformitetit dhe kriteret për marrjen e vendimeve mbi certifikimin. Diskutimi për standardet NDndihmëse si ISO/IEC 17067 dhe ISO/IEC 17030 ndihmoi në thellimin e njohurive të pjesëmarrësve. ISO/IEC 17067 përshkruan elementet kryesore të skemave të certifikimit të produkteve, duke ndihmuar trupat certifikuese të hartojnë dhe të zbatojnë skema që përmbushin kërkesat ndërkombëtare. ISO/IEC 17030, që lidhet me përdorimin e simboleve të vlerësimit të konformitetit, u trajtua për të siguruar që shenjat certifikuese të përdoren në mënyrë korrekte dhe në përputhje me kërkesat e tregut.

Ky trajnim përmirësoi aftësitë teknike të DPA-së, duke ndihmuar Shqipërinë të zhvillojë një sistem më të fuqishëm të certifikimit që përmbush kërkesat e tregjeve ndërkombëtare për siguri dhe gjurmueshmëri të produkteve.

Produkte të Parapaketuara - Rëndësia e Saktësisë dhe Sigurisë për Konsumatorët dhe Eksportet

Sektori i produkteve të parapaketuara është një nga segmentet më të rëndësishme për sigurinë dhe transpar-

encën në treg. Një gamë e gjerë produktesh blihen të parapaketuara, duke përfshirë ushqimet, pijet, detergjentët, produktet kozmetike, plehrat kimike dhe shumë të tjera. Për këtë arsye, transparenca dhe saktësia në lidhje me sasinë e produktit në këto paketime është thelbësore për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve dhe për të siguruar një konkurrencë të ndershme në treg. Për të garantuar këtë, legjislacioni metrologjik shqiptar ka vendosur kërkesa specifike për parapaketimet, përfshirë mbishkrimet, sasinë neto dhe shenjat e konformitetit.

Instituti i Metrologjisë (DPM) luan një rol kyç në garantimin e përputhshmërisë së produkteve të parapaketuara me standardet ndërkombëtare. DPM është përgjegjës për kontrollin metrologjik të këtyre produkteve, duke u siguruar që sasia nominale e deklaruar në paketim të përputhet me sasinë aktuale të produktit. Kjo jo vetëm që mbrohet konsumatorët, por gjithashtu ndihmon prodhuesit dhe eksportuesit shqiptarë të jenë konkurrenca në tregjet ndërkombëtare, ku kërkesat për saktësinë e peshës dhe volumit janë shumë strikte.

Pjesëmarrja e DPM në trajnimin treditur për ISO/IEC 17065 ishte një hap i rëndësishëm për forcimin e kapaciteteve të këtij institucioni. Ky trajnim kishte si qëllim pajisjen e stafit të DPM me njohuri të thelluara mbi certifikimin e produkteve të parapaketuara dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare.

Për DPM, ky trajnim është një mundësi për të rritur kapacitetet e tij dhe për të përmbushur kërkesat ndërkombëtare në mënyrë që të fitojë akreditimin për këtë shërbim. Kjo do të ndihmojë në rritjen e besueshmërisë së produkteve shqiptare në tregjet e huaja dhe do të kontribuojë në përmirësimin e standardeve kombëtare për sigurinë e produkteve të parapaketuara. Akreditimi do t'i mundësojë DPM-së të operojë me një infrastrukturë më të fuqishme, duke përmbushur kërkesat ligjore dhe duke forcuar pozicionin e produkteve shqiptare në tregun global.

GLOBALG.A.P dhe Praktikave të Mira Bujqësore - Çelësi për Eksportet dhe Rritjen e Tregjeve Ndërkombëtare

Më 10 dhe 11 tetor 2024, u zhvillua një trajnim intensiv dyditor mbi skemën e certifikimit GLOBALG.A.P, duke u fokusuar në parimet dhe rregulloret kyçe të kësaj skeme, e cila është një nga standardet më të rëndësishme për



certifikimin e praktikave të mira bujqësore në nivel global. GLOBALG.A.P mbulon disa aspekte kritike për bujqësinë,

Skemë turke për sigurimin e bujqësisë shqiptare. Çfarë është TARSIM dhe si funksionon ai? Primit i mbulon shteti

Shqipëria do të aplikojë modelin turk të sigurimeve në bujqësi. Ministria e Bujqësisë Anila Denaj, nënshkroi me homologun turk, Ibrahim Yumakli, deklaratën "Mbi bashkëpunimin në fushën e sigurimeve në bujqësi", duke shënuar një etapë të re në forcimin e marrëdhënieve diplomatike në këtë fushë.

Deklarata e nënshkruar synon të sjellë një model të ri sigurimesh për bujqësinë shqiptare, të ngjashëm me Fondin e Sigurimeve Bujqësore të Turqisë (TARSIM).

Por çfarë është sistemi TARSIM dhe si funksionon ai?

TARSIM është sistemi i sigurimeve bujqësore në Turqi, krijuar për të mbrojtur fermerët nga rreziqet natyrore dhe katastrofat që mund të dëmtojnë prodhimin e tyre bujqësor. Ai u krijua në vitin 2005 dhe përfshin një kombinim të sigurimeve private dhe mbështetjeje shtetërore.

Disa lloje të sigurimeve në bujqësi janë të detyrueshme, si sigurimi i të korrave, ndërsa të tjerat janë vullnetare, si sigurimi

për blegtorinë ose peshkimin. TARSIM mbulon një gamë të gjerë rreziqesh natyrore si:



MODELI TURK PËR SIGURIMIN E BUJQËSISË SHQIPTARE
ÇFARË ËSHTË TARSIM DHE SI FUNKSIONON AI? PRIMET I MBULON SHTETI

breshëri, stuhi, përmytje, tërmete, ngrica, sëmundje dhe dëmtues. Kjo i ndihmon fermerët të mbrojnë investimet e tyre dhe të zvogëlojnë humbjet financiare.

Shteti turk mbështet një pjesë të konsiderueshme të primeve të sigurimit, zakonisht nga 50% deri në 67%, duke e bërë atë më të përbalueshme për fermerët, raporton SCANTV.

TARSIM operohet nga një konsorcium i kompanive private të sigurimit, të mbështetura nga qeveria. Këto kompani

marrin pjesë në skemën e sigurimeve për bujqësinë përmes një platforme të përbashkët.

Në rast dëmtimi, fermerët aplikojnë për dëmshpërblim përmes agjencive të sigurimeve. Pas vlerësimit të dëmtimit nga ekspertët, fermerëve u kompensohet humbja brenda një kohe të shkurtër.

Përveç të korrave, fermerët mund të sigurojnë kafshët, peshqit dhe bimët nën ujë kundër sëmundjeve dhe fatkeqësive.

Kjo skemë konsiderohet një instrument i fuqishëm për menaxhimin e rrezikut në sektorin e bujqësisë, duke lehtësuar stabilitetin financiar të fermerëve.

Banka Evropiane e Investimeve, përfaqësi në Shqipëri - Qeveria miraton vendimin. Synon forcimin e partneritetit për zhvillimin e vendit

Qeveria shqiptare ka miratuar në parim marrëveshjen me Bankën Evropiane të Investimeve për hapjen e përfaqësisë së saj në Shqipëri.

Kjo marrëveshje vjen si pjesë e përpjekjeve për të forcuar partneritetin dhe për të përfutur nga financimet e BE-së në sektorë të rëndësishëm

Banka Evropiane e Investimeve po ofron mbështetje teknike për qeverinë e Shqipërisë për përgatitjen e projektit hekurudhor të Korridorit VIII në linjat hekurudhore Durrës – Rrogozhinë dhe Rrogozhinë – Pogradec.

Ndërkohë, Banka Evropiane e Investimeve, e cila është në pro-

siç është rehabilitimi i linjës hekurudhore Vorë- Hani i Hotit duke dhënë kredi për këtë projekt prej 100 mln euro. Marrëveshja për këtë qëllim u nënshkrua në muajin mars në selinë e Bankës Evropiane të Investimeve nga zv/kryeministria, njëherësh ministër e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku.

Rehabilitimi i kësaj linje hekurudhore parashikohet të sjellë një sërë përfitimesh në drejtimin e transportit, por edhe mjedisit. Ky projekt ka rëndësi jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për rajonin, duke lehtësuar lëvizjen e qytetarëve dhe mallrave.

Banka Evropiane e Investimeve ofron mbështetjen e saj në sektorë të rëndësishëm të ekonomive të vendeve të Ballkanit Perëndimor që aspirojnë të anëtarësohen në Bashkimin Evropian, siç është dhe Republika e Shqipërisë një kandidatë drejt anëtarësimit dhe integritetit në BE.



BANKA EUROPIANE E INVESTIMEVE, PËRFAQËSI NË SHQIPËRI
QEVERIA MIRATON VENDIMIN. SYNON FORCIMIN E PARTNERITETIT PËR ZHVILLIMIN E VENDIT

për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Por çfarë po financon konkretisht BEI në Shqipëri?

nësi të 27 qeverive të BE-së, po financon Shqipërinë në projekte infrastrukturore të rëndësishme,

Bashkimi mes aktorëve në nivel qarku, fuqizon kapacitetet për të hartuar projekte që adresojnë nevojat që ka sektori i agrobiznesit

Në zbatim të ligjit nr.36/2022 "Për organizimin dhe funksionimin e Grupeve Vendore të Veprimit", u organizua në Korçë takimi i radhës, ku ishin të pranishëm përfaqësues të agrobiznesit shqiptar, përfaqësuesja për vendin tonë e Organizatës për Zhvillim Industrial të Kombeve të Bashkuara znj. Elvana Zhezha, përfaqësues të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore të qarkut, të Universitetit "Fan S. Noli", Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Korçë, Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore dhe një përfaqësi e fushës së agrobiznesit në qark, kryesuar nga sipërmarrësi z. Gjergji Çibuku.

Përmirësimi i procesit të bashkëpunimit dhe koordinimit mes aktorëve të ndryshëm në qarkun tonë, me fokus kryesor mbështetjen e sektorit të fruta-

perimeve, bimëve mjekësore dhe aromatike, përmes themelimit të mbështetjes së Grupeve Vendore të Veprimit, ngelet një objektivi i përbashkët.

Krijimi i një bashkimi të tillë mes aktorëve në nivel qarku, do të fuqizojë kapacitetet për të hartuar projekte që

adresojnë nevojat që ka sektori i agrobiznesit, si përpjekje e integruar institucionale në bashkëpunim me universitetin e sektorin privat, duke rritur thelbësisht shanset për të përfutur grante nga donatorë të huaj, në dobi të fermerëve të qarkut tonë.



'Expo Albania' qendër e re për koncerte e panairë! Do ndërtohet në Farkë të Tiranës, 6 ha sipërfaqe, brenda edhe hotele me 3-4 yje

Një qendër shumëfunktionale do të ndërtohet në Farkë, ku do të zhvillohen panairë, evente apo koncerte. Qendra Expo Albania më e madhja në Ballkan do të ketë brenda territorit të saj edhe hotele me 3-4 yje. Qeveria thotë se ky investim në pronën shtetërore, do sjellë miliona të ardhura në buxhet si dhe do tërheqë investitorë të huaj.

Viti 2030 do ta gjejë vendin me një qendër multifunksionale Ekspo Albania Biznes, ku do të organizohen evente, panairë e deri tek koncerte.

Blendi Gonxhja.

"Expo Albania do të jetë qendra më e rëndësishme e panairëve dhe ekspozitave në Ballkan dhe do ta vendosë

"Krijimi i këtij poli të ri zhvillimi për qytetin, në një zonë pranë Tiranës, do të shërbejë për të shpërndarë punësimin dhe zhvillimin më gjerë në territorin e kryeqytetit", tha Gonxhja.

Plani i qeverisë tha Gonxhja është transformimi i të gjitha pronave shtetërore të braktisura, duke përfshirë edhe dhënie të tyre me koncesion në këmbim të zyrave për administratën.

"Projekte të shumta të AIC, përfshirë megaprojektin për të ofruar një ambient të ri dhe dinjitoz për 22 institucione dhe mbi 10 mijë punonjës të administratës, gëzojnë suport të plotë nga Ministria jonë. MEKI do të vijojë të nxisë transformimin e zonave të braktisura në qendra zhvillimi, përmes partneritetit publik-privat dhe do të mbështesë përzgjedhjen e partnerëve të përshtatshëm, përmes garave të suksesshme ndërkombëtare", tha ministri.

Gjatë konferencës diskutuar qendër qendër që do të ndërtohet në Farkë, nuk munguan as disa shifra mbi turizmin, ku ministri i Ekonomisë tha se viti 2024 do të mbyllet me 13 milionë pushues të huaj.

Shqipërinë në hartën e një industrie me rritje të shpejtë: atë të panairëve dhe ekspozitave. Industria e panairëve dhe ekspozitave përfaqëson sot një treg me vlerë dhjetëra miliardë euro dhe rreth 35 mijë evente në vit, që rritet me shpejtësi, madje përfshirë me shumë se pesë vite më parë", tha Gonxhja.

Ngritja e një qendre të tillë është edhe ftesë për të huajt, për të investuar në Shqipëri edhe në këtë industri.



REPORT TV

Qendra do të ndërtohet në ish-zonën ushtarake të Farkës në Tiranë me sipërfaqe prej 6 hektarësh, brenda së cilës do të ketë edhe hotele me 3 apo 4 yje. Qendra do të përfshijë disa salla ekspozimi, konferencash dhe mbledhjeje, auditorë si dhe të gjitha hapësirat e nevojshme mbështetëse, teknike dhe të magazinimit.

Ekonomia do të përfutur miliona euro nga industria e eventeve u shpreh ministri i

Agroturizmet, qendra ekonomike që nxisin zinxhirin e prodhimit në zonat rurale

Agroturizmet po kthehen në qendra të zhvillimit ekonomik rural, duke krijuar një perspektivë të mirë në nxitjen e zinxhirit të prodhimit ushqimor.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj ndau në rrjete sociale modelin e agroturizmit "Rrezja e Diellit," aty ku mikpritja e ngrohtë e familjes Çullhija, ka ngritur një oaz qetësie dhe relaksimi.

Denaj tha se në këtë pikë agroturistikë frekuentohet nga turistë vendas dhe të huaj, që

shijojnë shijen autentike të kulinarisë shqiptare dhe produktet cilësore "Made in Albania", nga ferma në tryezë.

"Vera e tyre artizanale, prodhuar me kujdes nga vreshtat e fermës, pasqyrojnë traditën, pasionin dhe përkushtimin e familjes për të ruajtur vlerat e prodhimeve shqiptare", tha Denaj.

Ferma ka dy vite që është hapur. Aty gjenden dy hektarë vreshta dhe është e rrethuar nga ullinj shekullorë. Produktet e zonës janë baza e gati-

meve që u serviren vizitorëve të shumtë.

Ndërsa kantina e verës është një aset i shtuar në gamën e prodhimeve cilësore "Made in Albania".

Sipërmarrësit në këtë investim familjar shprehën se agroturizmi i tyre tashmë po funksionon edhe si qendër ekonomike për fshatin e tyre, pasi ata u blejnë fermerëve të zonës produkte të ndryshme për të plotësuar nevojat e kuzhinës dhe klientëve.

BUJQËSI

Fasulja në Kukës shitet 500-600 lekë për kg, konsumatorët: Çmimi është i lartë

Këtë vit çmimi i fasuleve të reja në Kukës varion nga 500 lekë në 600 lekë për kg. Kushtet jo të favorshme klimatike bënë që këtë vit prodhimi i kulturës së fasules të ishte më i pakët duke munguar në treg ndërsa për konsumatorët ky çmim mbetet i papërbalueshëm.

Një pjesë e banorëve që jetojnë në fshatra thonë se ndonjëse kanë mbjellë fasulet prodhimi nuk ju mjafton as për familjet e tyre.

Për stinën e dimrit, një familje duhet të siguroj deri 40 kg fasule. Ndryshe nga produktet e tjera për blerësit fasulja e importuar po blihet

më se shumti kjo për shkak të çmimit më të ulët.



Zhvillimi i turizmit malor në Pukë, kryebashkiaku: Emigrantët të investojnë në vendin e tyre

Puka është një ndër zonat turistike të pashfrytëzuara në Shqipëri. Për këtë arsye fokusi i pushtetit vendor është

ekonomisë e kësaj zone.

Kryebashkiaku, Rrok Dodaj e cilëson këtë vit të suksesshëm në turizëm.

huaj dhe vendas. Ne po bëjmë takime dhe thirrje për biznesmenë apo emigrantë që kanë emigruar të vijnë të investojnë në Pukë në fushën e turizmit. Turizmi është primar", tha Dodaj.

Për arritjen e këtyre ambicioneve dhe kthimit të Pukës në një atraksion turistik, Dodaj tha se duhen dhe shumë investime të cilat shpreson t'i realizojë përmes bashkëpunimit me qeverinë.

"Të bësh një turizëm të qëndrueshëm do të thotë të investohet aty. Projektet janë ambicioze, shpresojmë që thirrjet të merren parasysh nga qeveria dhe nëse ka qasje pozitive do të ketë lehtësim edhe për bizneset", tha Dodaj.

Puka mund të konsiderohet tashme si një prej destinacioneve të turizmit Shqiptar. Ajo çfarë mbetet domosdoshmëri është shtimi i njësive akomoduese.



zhvillimi i turizmit malor si një mundësi e mirë edhe për

"Përsa i përket turizmit këtë vit, ka pasur shumë lëvizje të

Nis shitja e patates në Korçë, problem çmimi i ulët i kërkuar nga tregtarët

Fermerët e fushës së Malit po vijojnë me mbledhjen e patateve ndërsa ky vit ka pasur një prodhim përgjithësisht të mbarë të kësaj kulture bujqësore.

Luljeta Shaholli ka mbjellë një sipërfaqe prej 24 HA me patate dhe thotë se janë të kënaqur me prodhimin e marrë por ngre si shqetësim, çmimin e ulët me të cilin po kërkohet në treg.

"Si prodhim e kemi shumë të mirë me cilësi të mirë, por tregun e shitjes e kemi të vështirë. Edhe si çmim që kërkohet është shumë i ulët", tha Shaholli.

Shaholli bën me dije se kanë përygjedhur disa varietete patatesh të cilat kanë dhënë rendiment të lartë pasi

i përshtaten më së miri klimës së zonës

Një ndër problematikat kryesore që kanë hasur fermerët gjatë viteve të fun-

dit është mungesa e fuqisë puntore për vjeljen e prodhimit por Shaholli thotë se nuk e kanë vuajtur këtë pjesë.



Mbarështimi i bagëtive, Besart Bilali, i riu që u rikthye në Bicaj të Kukësit

Mbarështimin e bagëtive e ka të trashëguar ndër breza. Besart Bilali i kthyer nga emigrimi pas 7 viteve qëndrim vendosi të investojë në vendin e tij.

Nuk është vetëm familja e përfshirë në këtë punë, por ai ka punësuar edhe të tjerë. Interesi është i lartë për mishin e kësaj zone si nga banorët e Kukësit, por edhe më gjerë. Veç përfitimeve, kjo punë ka edhe vështirësi tregon Bilali, pjesa më e vështirë është sigurimi i ushqimit duke ditur që numri i krerëve është i lartë.

Sa i përket subvencioneve, është një shtysë për të zhvilluar dhe zgjeruar stallën.

"Tre vitet e fundit kam marrë subvencione edhe këtë vit po presim që të dalin", tha ai.

Veç lopëve kjo familje mbarështon edhe të imta, ku

Të emigrosh me qëllim për t'u kthyer e investuar në vendin



numëron mbi 300 krerë dele, një pjesë janë në stallë, e pjesa tjetër në kullota.

tënd, është një shembull për t'u vlerësuar dhe mbështetur e ky rast është Besarti nga fshati Bicaj.

Familja Fejzulla sjell shijen tradicionale të verës së Leskovikut

Leskoviku njihet për natyrën e bukur të tij, për këngët, mikpritjen e në mënyrë të veçantë për prodhimin e verës e të rakisë. Duke shfrytëzuar traditën e kësaj zone, familja Fejzulla ka ngritur një fermë për kultivimin e rrushit, i cili vjen në një cilësi të lartë.

Familja Fejzulla është kujdesur që të kultivojë në fermën e vet kultivarë të vjetër autoktonë dhe t'i bëjë ata të njohur përmes verës së prodhuar edhe jashtë kufijve.

Kushtet atmosferike të favorshme të Leskovikut, zonës së njohur për prodhimin e verës dhe rakisë patjetër që janë një

faktor i rëndësishëm, por edhe rinovimi i teknologjisë së përpunimit të rrushit vitet e fundit

nga kjo kompani kanë bërë që vera e prodhuar të shkojë edhe për eksport.



Dita Ndërkombëtare e Grave Rurale, historia e Dritës që vazhdon traditën e tezgjahut

Dita Ndërkombëtare e Grave Rurale festohet çdo vit më 15 tetor dhe kjo ditë i kushtohet miliona grave që jetojnë në zona të largëta, rurale, për

të rrallë, vazhdon traditën e tezgjahut që e ka trashëguar nga ëma dhe tashmë po ia kalon edhe vajzës së saj, Jonidës. Puna e saj është më shumë se

lehtë, por se do ta vijojë pasi sa i vështirë është si zanat, po aq është edhe i bukur.

"Ëndrrat duan punë. Këtë zanat e kam trashëguar nga nëna ime dhe vazhdoj ta trashëgoj te ime bijë. Është zanat i vështirë, por i bukur", shprehet Drita.

Ndërsa Jonida, e bija, thotë se tradita e tezgjahut është ndër ato tradita që ia vlen për t'u ruajtur dhe është shumë e vyer.

"E kam trashëguar nga ime më dhe nga gjyshja. Ato e punonin tezgjahun me shumë dashuri, që e përcollën edhe tek unë. Kjo më shtyn më tepër ta vijoj, të mos e lëmë të zhduket. Kam hyrë në tezgjah që e vogël, dhe shpesh edhe pa i marrë leje time mëje, duke ia prishur jo pak herë. Tani e kuptoj që e dua edhe unë", thotë ajo.

Gjatë shekujve, gratë dhe vajzat në zonat rurale, janë angazhuar në shumë aspekte të jetës së përditshme të komuniteteve të tyre. Ato kanë luajtur një rol kyç në bujqësi, prodhimin ushqimor, mirëmbajtjen e familjeve dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të zonave rurale.



të festuar dhe theksuar arritjet dhe kontributet e tyre në zhvillimin rural dhe bujqësinë.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj zgjodhi të urojë gratë në këtë ditë me historinë e një gruaje, e cila me një përkushtim të rrallë vazhdon traditën e tezgjahut, dhe tashmë po ia kalon edhe të bijës.

"Drita, me një përkushtim

një zanat, është një urë që lidh të kaluarën me të ardhmen, një rrugë që na tregon se fuqia e grave rurale nxit ruajtjen e vlerave kulturore, përbën një burim të ardhurash për ekonominë familjare dhe atë lokale, si dhe kontribuon në zhvillimin rural", tha ministria Denaj.

Vetë Drita Gordi tregon se tezgjahu nuk është një punë e

E drejta për ushqim në Evropë dhe Azinë Qendrore

Një thirrje për angazhime më të forta

Juan Echanove, udhëheqës i FAO-s për të Drejtën për Ushqim
Viorel Gutu, Ndhimës Drejtori i Përgjithshëm i FAO-s dhe Përfaqësues Rajonal
për Evropën dhe Azinë Qendrore



kur ka ndodhur. Në të vërtetë, të gjithë palët e interesuara, duke përfshirë qeveritë në Evropë dhe Azinë Qendrore, kanë ndjekur një numër të madh të këtyre udhëzimeve që kërkojnë të sigurojnë disponueshmërinë, aksesueshmërinë, dhe përshtatshmërinë e ushqimit. Shembuj të veprimeve të tilla përfshijnë subvencionet për fermerët, etiketat ushqimore, programet e ushqimit në shkolla, standardet e sigurisë ushqimore, promovimin e bujqësisë së qëndrueshme, GLOBALG.A.P., dhe shumë organizata të shoqërisë civile (OSHC) që kanë zbatuar nisma të bazuara në komunitet për të adresuar drejtpërdrejt pasigurinë ushqimore, si bankat e ushqimit, kopshtet e komunitetit dhe programet e edukimit të të ushqyerit. Ndërsa efektiviteti i këtyre veprimeve mund të ndryshojë, ato së bashku kontribuojnë në realizimin progresiv të kësaj të drejte në rajon. Çdo pak ndihmon.

Udhëzimet e së Drejtës për Ushqim ofrojnë një gamë të gjerë rekomandimesh për të nxitur realizimin progresiv të kësaj të drejte në kontekstin e sigurisë kombëtare ushqimore. Ndërsa qeveritë kanë një përgjegjësi kryesore, duke ndërmarrë hapa për të siguruar që qytetarët e tyre të kenë akses në ushqim të mjaftueshëm, të sigurt dhe me vlera ushqyese, udhëzimet inkurajojnë gjithashtu komunitetin ndërkombëtar, shoqërinë civile dhe sektorin privat për të mbështetur këto përpjekje dhe për t'u angazhuar në mënyrë aktive.

Çdo zbatim gjatë dy dekadave të fundit, sado i vogël, ka kontribuar në realizimin progresiv të së drejtës për ushqim, pavarësisht se nga kush dhe

përmes programeve, të tilla si Programi Evropian i Fqinjësisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (ENPARD), i cili është fokusuar në forcimin e kapaciteteve të operatorëve të biznesit ushqimor dhe fermerëve të vegjël dhe pozicionin në sistemet agrourbore, zhvillimin e kooperativave për të përmirësuar sistemet lokale të ushqimit dhe forcimin e qeverisjes dhe sistemit zyrtar të kontrollit të ushqimit për ushqim të sigurt. Në Azinë Qendrore, vende si Uzbekistani kanë bërë përpjekje të rëndësishme në sigurinë ushqimore përmes programeve kombëtare që synojnë përmirësimin e standardëve të higjienës në prodhimin dhe përpunimin e ushqimit, duke siguruar që produktet ushqimore të përmbushin standardet ndërkombëtare të sigurisë për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit.

Është shqetësuese që legjislacioni specifik për të drejtën për ushqim mbetet i pazhvilluar brenda BE-së dhe në vende të tjera Evropiane dhe Azisë Qendrore. Këshilli i Evropës nuk ka krijuar ende një instrument ligjor që mbron në mënyrë eksplicite këtë të drejtë dhe shumë kombeve në rajon u mungojnë kornizat ligjore gjithëpërfshirëse për ta zbatuar atë.

Udhëzimet Vullnetare bëjnë një sërë rekomandimesh, duke përfshirë zhvillimin e strategjive kombëtare të sigurisë ushqimore, kornizave ligjore dhe rregullimeve institucionale, promovimin e sistemeve të qëndrueshme ushqimore, sigurimin e mbrojtjes sociale, nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe krijimin e mekanizmave monitoruese. Megjithatë, politikat dhe programet janë vetëm mjete për një qëllim. Ajo që ka me të vërtetë rëndësi është përpunimi i botës reale, duke mos lënë askënd pas, veçanërisht

grupet e cenueshme si fëmijët, gratë, të moshuarit (sektori me



rritje më të shpejtë në zonat rurale) dhe grupet etnike të marginalizuara.

Në këtë kuptim, realizimi progresiv i të drejtës për ushqim ka qenë i pabarabartë në të gjithë rajonin. Sipas FAO-s, numri i personave, me pasiguri mesatare ushqimore ose të rëndë në vitin 2023, ka kaluar 111 milionë. Vazhdojnë pabarazitë e konsiderueshme në aksesin ndaj ushqimeve të shëndetshme me vlera ushqyese, veçanërisht në mesin e popullatave vulnerabël si në zonat urbane, peri-urbane dhe rurale. Përballeshmëria e ushqimit është gjithashtu një shqetësim i vërtetë. Në vitin 2022, për shkak të inflacionit të lartë, 8.3 përqind, qytetarët e BE-së nuk mund të përballonin një vakt që përmban mish, peshk ose një ekuivalent vegjetarian çdo ditë, dhe në vende si Armenia, gati 15 përqind e popullsisë përballet me sfida të ngjashme në aksesin e ushqimit adekuat. Përqendrimi në rritje i prodhimit dhe shpërndarjes së ushqimit në duart e disa korporatave të mëdha i përkeqëson këto pabarazi, duke kufizuar diversitetin dhe aksesin e ushqimit.

Kjo ka çuar në një mjedis ushqimor të dominuar nga produkte ultra të përpunuara, të larta në sheqerna, yndyrna dhe aditivë,

që lidhen me rritjen e niveleve të obezitetit dhe sëmundjeve të lidhura me dietën në të gjithë kontinentin. Në Azinë Qendrore, dietat tradicionale po zëvendësohen gjithnjë e më shumë nga opsione më pak ushqyese, duke çuar në një barrë të dyfishtë të keqshqyerjes, duke përfshirë keqshqyerjen dhe aneminë tek gratë e moshës 15 deri në 49 vjeç, ku të dyja janë nën ushqyerje, si dhe gjatë shtatzanisë, të fëmijët nën pesë vjeç, në disa vende të Azisë Qendrore, Kaukazit dhe Shteteve të Pavarura të Komonvelthit (CIS) Evropë dhe Ukrainë: Azerbajxhan (13.3 përqind), Tashkistan (13.1 përqind), Ukrainë (12.3 përqind) dhe Kirgistan (10.3 përqind).

Mbipesha të fëmijët nën pesë vjeç, anemia tek gratë e moshës 15 deri në 49 vjeç dhe obeziteti i të rriturve janë në rritje në një numër vendesh të rajonit. Ballkani Perëndimor (10.3 përqind) dhe Kaukazi (9.1 përqind) kanë shkallën më të lartë të mbipeshës tek fëmijët nën pesë vjeç. Prevalenca rajonale e obezitetit të të rriturve është në rritje dhe është mbi vlerësimin global. Vlerat e anemisë tek gratë e moshës 15 deri në 49 vjeç tejkalojnë vlerësimin global (29.9 përqind) në Kirgistan (35.8 përqind), Tashkistan (35.2 përqind) dhe Azerbajxhan (35.1 përqind).

Për të adresuar këto sfida që lidhen me keqshqyerjen, të gjitha palët e interesuara në Evropën dhe Azinë Qendrore duhet të fokusohen në cilësinë ushqimore, duke siguruar që të gjithë qytetarët të kenë akses fizik dhe ekonomik në një dietë të mjaftueshme, të larmishme dhe të ekuilibruar. Askush nuk duhet të lihet pas. Kjo duhet të mbështetet nga fushatat e edukimit dhe ndërgjegjësimit publik që inkurajojnë zgjedhje më të

shëndetshme dhe më të qëndrueshme ushqimore. Veprimet e sektorit privat për përbërësit dhe përbërjen e ushqimit, praktikat e shitjes me pakicë dhe marketingut kanë rëndësi. Ekziston gjithashtu nevoja për të forcuar mbështetjen për bujqësinë e qëndrueshme që promovon biodiversitetin, duke përfshirë ruajtjen e sistemeve ushqimore lokale dhe tradicionale në rajone si Ballkani Perëndimor, Kaukazi dhe Azia Qendrore.

Angazhimi i shoqërisë civile, fermerëve në shkallë të vogël dhe komuniteteve lokale në politikëbërje është thelbësor për krijimin e politikave gjithëpërfshirëse që trajtojnë në mënyrë efektive pasigurinë ushqimore. Një hap i fundit dhe shumë domethënës në këtë drejtim ishte Forumi II për të Drejtën e Ushqimit, i mbajtur në Gjenevë në maj 2024. Ky aktivitet mblodhi së bashku specialistë nga e gjithë Evropa për të diskutuar çështje kritike që lidhen me sigurinë ushqimore, sovranitetin ushqimor dhe të drejtën për ushqim, duke lëvizur drejt një Iniciativë Qytetare Evropiane të fokusuar në sigurimin e propozimeve gjithëpërfshirëse për sisteme të qëndrueshme ushqimore.

Rajoni ka potencialin për të udhëhequr iniciativat globale të së drejtës për ushqim duke promovuar sisteme ushqimore të qëndrueshme, të barabarta dhe gjithëpërfshirëse në marrëveshjet ndërkombëtare të tregtisë dhe bashkëpunimit zhvillimor të vendosura tek të drejtat e njeriut.

Ndërsa përkujtojmë 20 vjetorin e miratimit të Udhëzimeve Vullnetare për të Drejtën për Ushqim të Përshtatshëm, Evropa dhe Azia Qendrore duhet të shfrytëzojë këtë mundësi për të forcuar angazhimin e tyre. Duke udhëhequr rugën në zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit, politikave dhe bashkëpunimit të fuqishëm për të drejtën për ushqim në nivel global, rajoni mund të japë një shembull të fuqishëm, duke siguruar që të gjithë qytetarët e tij të kenë akses në ushqimin që u nevojitet për një jetë të shëndetshme dhe aktive.

Është koha për ta kthyer në realitet "Të Drejtën për Ushqime" për një dietë të shëndetshme, ushqyese dhe të përballueshme

Nga Dr. QU Dongyu, Drejtor i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë



rreth 730 milionë njerëz po përballen me urinë për shkak të

fatkeqësisë të shkaktuara nga njeriu dhe ato natyrore, duke

përfshirë konfliktin, goditjet e përsëritura të motit, pabarazitë dhe rëniet ekonomike.

Miliarda njerëzve u mungojnë dietat e shëndetshme

Një tjetër realitet i ashpër është se mbi 2.8 miliardë njerëz në botë nuk janë në gjendje të përballojnë një dietë të shëndetshme, e cila është shkaku kryesor i të gjitha formave të keqshqyerjes.

E thënë thjesht, pothuajse një e treta e popullsisë globale sot nuk po merr lëndët ushqyese dhe mikronutrientët që u nevojiten për të jetuar shëndetshëm dhe, në disa raste, për

të mbijetuar. Kjo do të thotë se cilësia e jetës për afro gjysmën e botës ka nevojë urgjente për përmirësim.

Ne kemi nevojë për një larmi më të madhe ushqimesh me vlera ushqyese dhe të përballueshme që të jenë të disponueshme në fushat tona, rrjetat e peshkimit, tregjet dhe tryezat tona, për të mirën e të gjithëve. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me kërkesat ushqimore të popullatave, por edhe me sigurimin që sistemet tona agrourbore të jenë efektive, gjithëpërfshirëse, elastike dhe të qëndrueshme, në mënyrë që ata të mund të respektojnë kulturat

tradicionale ushqimore dhe dietat e shëndetshme të bazuara në shkencë dhe në përputhje me preferencat personale.

Një aspekt tjetër thelbësor është shëndeti dhe qëndrueshmëria afatgjatë e mjedisit në të cilin ne mbështetemi për të prodhuar këto ushqime, i cili ka nevojë për biodiversitet për të lulëzuar.

E drejta për ushqime në vetvete nuk do të thotë plotësimin e nevojave imediate të ushqyerjes, ose të vendosë diçka më të larmishme në pjatat tona. Por kjo ndihmon në përcaktimin e aspiratave tona kolektive për llojin e botës së drejtë dhe të barabartë në të cilën duam të jetojmë. Krijon detyrime konkrete për qeveritë dhe partnerët kryesorë për t'i përmbushur dhe duhet të na inkurajojë të

AKTUALITET

Diagnoza - Pse mungon skema e sigurimit në bujqësi? - Rrapaj: Përgjegjësia bie mbi 4 aktorë. Guri: Nuk është luks, por domosdoshmëri

Ndërsa kemi hyrë zyrtarisht në sezonin vjeshtë-dimër, fermerët shqiptarë janë

nuk ofrohen në këtë proces sepse është jo dobiprurës nga pikëpamja e fitimi, donatori kërkon

lidhen me sigurimin në bujqësi që janë ngjarjet e rrezikut që vijnë nga kushtet e motit përsëriten në mënyrë të vazhdueshme dhe më të shpeshtë. Nëse në 30 vitet e shkuara episodet e breshërit në Shqipëri sinjalizoheshin në 1 në çdo 3 ose 4 vjet, sot epodoet e breshërit dhe flasin për një nga ngjarjet e rrezikut më shkatërruese përse i përket prodhimit, përsëriten çdo vit. Që bën që çdo vit ata të jenë përballë një rreziku potencial që prodhimi i tyre të shkatërrohet në 10-20-30-50 apo 100%. Në këto kushte nuk është më një luks që të sigurohesh, por është një domosdoshmëri duke pasur parasysh



Agim Rrapaj
Kreshmëtar i KASH

tërisht të pambrojtur ndaj fenomeneve me rrezikshmëri natyrore, siç janë përmbytjet, breshëri, ngricat apo stuhitë, për shkak se mungon një skemë e mirëfilltë sigurimi, duke i bërë ata që në këto kushte të çojnë dëm të gjithë mundin e tyre. Por pse mungon një skemë sigurimi në Shqipëri dhe çfarë e pengon atë?

“Jemi aktualisht në një pozicion që nuk kemi një skemë sigurimi që të që të kënaqë interesat e fermerëve, nuk e kemi sepse nuk ekziston një vullnet për të bashkëpunuar të katër aktorë, qeveria, donatorët, fermerët dhe kompanitë e sigurimeve. Këta aktorë duhet të bashkëpunojnë, të ndërveprojnë me njëri tjetrin, në mënyrë të tillë që ti ofrojnë këtij sektori që është i vështirë, një skemë që të jetë e pranueshme dhe e përballueshme nga të katër aktorët. Deri tani të gjithë barrën e peshës dhe të sakrificës ia kemi lënë fermerit. Nëse ndodh breshër i dëmtohet prodhimi dhe e mban ai gjithë peshën, shoqëritë e sigurimit



një vullnet të tre këtyre aktorëve që të vijë se nuk vjen.

Ekspertët analizojnë arsyet se pse nevojitet një skemë sigurimi në sektorin bujqësor shqiptar

Neve na duhet një skemë sigurimesh sepse sot më shumë se kurrë shohim problematika që

që ne gjendemi në kushtet e nivelit më të ç'balancuar përse i përket reshjeve, nga ana tjetër, thatësira më të gjata, episode breshëri dhe kështu me radhë”.

Së fundmi, Ministria e Bujqësisë ka nënshkruar një marrëveshje me qeverinë turke në fushën e sigurimeve në bujqësi, për të marrë eksperiencën nga modeli TARSIM që aplikon ky shtet.

BERZH dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania nxisin investimet e gjelbra në sektorin rezidencial të Shqipërisë

Kredia do të mbështetet nga Bashkimi Evropian dhe Japonia

- BERZH do të ofrojë €3 milionë për kreditim ndaj shtëpive shqiptare dhe kompanive të ndërtimit për të nxitur investimet e gjelbra në sektorin e ndërtesave të banimit.
- Kredia do të mbështetet nga Bashkimi Evropian dhe Japonia.
- Pronarët e shtëpive do të marrin grant deri në 20 për qind të vlerës së kredisë.

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) po jep një kredi prej 3 milionë eurosh për Intesa Sanpaolo Bank Albania për kreditimin e mëtejshëm të individëve dhe kompanive të ndërtimit me synimin për të përmirësuar standardet e gjelbra në këtë sektor.

Kredia do të mbështetet nga Bashkimi Evropian (BE) përmes Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) dhe Fondit të Bashkëpunimit Japoni-BERZH.

Huaja e BERZH-it në kuadër të programit Green Economy Financing Facility (GEFF) do të mbështesë eficientën e energjisë dhe investimet në energjinë e rinovueshme nga banorët individë, kolektivët e banesave, kompanitë e ndërtimit dhe sektori publik. Me instalimin e suksesshëm të teknologjive të gjelbra, pronarët e shtëpive do të përfitojnë nga pagesat stimuese që do të arrijnë deri në 20 për qind të vlerës së kredisë.

Ekaterina Solovova, Drejtuesja e BERZH për Shqipërisë, tha: “Ne jemi të kënaqur që vazhdojmë të mbështesim tranzicionin e ekonomisë së gjelbër në Shqipëri. Financimi i GEFF do të mundësojë investime të rëndësishme në ndërtesat e banimit duke rritur eficientën energjike, dhe rrjedhimisht sjell uljen e faturave të energjisë për qytetarët shqiptarë dhe kursim energjie për vendin”.

Alessandro D’Oria CEO i Intesa Sanpaolo Bank shtoi: “Që nga viti 2015, Intesa Sanpaolo Bank Albania ka bashkëpunuar dhe zbatuar projekte të suk-



sesshme në bashkëpunim me BERZH-in për të mbështetur bujqësinë, turizmin, gratë në biznes dhe të rinjtë në biznes. Gjithashtu, së bashku kemi përmbyllur financime të qenësishme të projekteve të rëndësishme për infrastrukturën, energjinë dhe turizmin e qëndrueshëm të vendit. Nëpërmjet këtij financimi të ri, ne do të mundësojmë investimet e gjelbra për familjet sipas strategjisë sonë ESG”.

Financimi i GEFF do të sigurojë financimin për të mbështetur investimet në teknologjitë e gjelbërta me performancë të lartë, materiale të qëndrueshme dhe zgjidhje inovative për banesat dhe ndërtesat e banimit në pronësi private.

Së bashku me aksesin në financim nëpërmjet kredive GEFF, pronarët e shtëpive do të marrin udhëzime për zgjedhjen dhe blerjen e pajisjeve të kursimit të energjisë, të tilla si izolimi, dritaret, pompat e nxehtësisë dhe panelet diellore, të cilat do të reduktojnë emetimet e gazeve serrë, do të ulin kostot e energjisë

dhe do të përmirësojnë cilësinë e jetës së tyre.

Programi GEFF i BERZH-it ka ndihmuar më shumë se 18,500 pronarë shtëpish në rajonin e Ballkanit Perëndimor për të përmirësuar efikasitetin e tyre të energjisë. Në përgjithësi, programi ka kontribuar në rreth 260,000 MWh kursime të energjisë dhe një reduktim prej më shumë se 25,000 ton emetime CO2 në vit në Ballkanin Perëndimor.

Intesa Sanpaolo Bank Albania, pjesë e Grupit Intesa Sanpaolo, është një bankë lider në vend që ofron shërbime bankare cilësore, zgjidhje financiare, produkte dhe shërbime inovative për korporatat, klientët institucionalë dhe me vlerë neto të lartë, bizneset e vogla dhe të mesme dhe klientët individualë. Intesa Sanpaolo Bank Albania është një partner afatgjatë i BERZH-it, me një histori të suksesshme në financime të shumta.

BERZH, një investitor institucional kryesor në Shqipëri, ku ka investuar mbi €2.1 miliardë në mbi 153 projekte në vend deri më sot.

FAO

(Vijon nga faqja 6)

gjithëve që të bëjmë pjesën tonë për të siguruar realizimin e saj. Kjo është arsyeja e veprim-it. Tani.

Roli i FAO-s

Në Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO) ne po punojmë shumë për ta kthyer këtë të drejtë në realitet, edhe përballë një sërë sfidash. Në zonat e konfliktit, qasja në ushqime është duke u ndërprerë, duke çuar në kequshqyerje dhe uri. Në këto dhe pika të tjera të nxehta të urisë, përpjekjet e FAO-s përqendrohen në rindërtimin e infrastrukturës bujqësore për të siguruar disponueshmërinë e ushqimit dhe aksesin për sigurinë ushqimore afatgjatë, me të gjitha mjetet dhe kanalet.

Përveç ndërhyrjeve të tilla emergjente, programet kryesore të FAO-s si iniciativa Dorë për Dorë (Hand për Hand), Një Vend Një Produkt Prioritar (One

Është koha për ta kthyer në realitet “Të Drejtën për Ushqime” për një dietë të shëndetshme, ushqyese dhe të përballueshme

Country One Priority Product), Ekonomia Blu dhe Programet e Bashkëpunimit Teknik (TCP) synojnë gjithashtu sigurinë ushqimore dhe ushqimin afatmesëm dhe afatgjatë në një gamë të gjerë vendesh.

Në shumë vende, ndryshimet dietike dhe përqendrimi i tregut nxitur nga globalizimi kanë çuar në rritjen e problemeve shëndetësore, duke përfshirë obezitetin dhe diabetin. Programet e të ushqyerit në shkollat të mbështetura nga FAO luajnë një rol të rëndësishëm për të ndihmuar në adresimin e këtyre sfidave, pasi ato e marrin ushqimin nga fermerët vendas dhe sigurojnë që fëmijët të marrin ushqime me vlera ushqyese.

Në shumë vende, në të gjitha rajonet, FAO po punon me komunitetet e peshkimit dhe qeveritë lokale për të zgjeruar mbrojtjen sociale dhe përfshirjen ekonomike të më të

cënuarve duke i ndihmuar ata të diversifikojnë prodhimin e tyre, të ndërtojnë burime alternative të të ardhurave dhe të lidhen me tregje të reja.

Inflacioni, veçanërisht gjatë periudhave të paqëndrueshmërisë ekonomike, mund ta bëjë ushqimin të papërbalueshëm. Në disa vende afrikane, për shembull, iniciativat e FAO-s përfshijnë transferatë të parave për familjet më të varfra, duke i ndihmuar ata të përballojnë ushqimin gjatë hiperinflacionit.

Kriza klimatike përbën një kërcënim të madh për sigurinë globale të ushqimit. Modelet e parregullta të motit dhe fatkeqësitë natyrore mund të shkatërrojnë të korrat dhe bagëtinë. Për shembull, në disa vende të Azisë FAO ka prezantuar teknika bujqësore të zgjuara me klimën për të ndihmuar fermerët të përshtaten me ndryshimin e kushteve kli-

matike, duke siguruar prodhim të qëndrueshëm të ushqimit.

Për më tepër, duke punuar ngushtë me qeveritë, FAO ndihmon në zhvillimin e kornizave ligjore dhe ka ndihmuar në hartimin e politikave kombëtare drejt garantimit të sigurisë ushqimore dhe ushqyerjes për të gjithë.

Duhet veprim kolektiv

Por nuk janë vetëm qeveritë që ne u bëjmë thirrje të përfshihen në këtë betejë. Veprimi kolektiv mund të nxisë ndryshime thelbësore, me bashkëpunim global nga të gjithë sektorët dhe të gjithë partnerët - qeveritë, sektori privat, academia, shoqëria civile dhe individët.

Dhe veçanërisht të rinjtë - sepse një e ardhme e sigurt ushqimore është e drejta e tyre. Ata projektojnë dhe vendosin të ardhmen. Të gjitha thirrjet nga Samiti

i OKB-së për të Ardhmen përcaktohen nga veprimet e tyre.

Fermerët mund të bëjnë një ndryshim duke praktikuar bujqësi të qëndrueshme që rrit biodiversitetin dhe menaxhon burimet natyrore me përgjegjësi. Bizneset mund të bëjnë të disponueshme ushqime me vlera ushqyese dhe të larmishme në mënyrë më të përballueshme. Akademia dhe shoqëria civile mund t'i mbajnë qeveritë përgjegjëse duke mbledhur të dhëna, duke identifikuar fushat për përmirësim, duke zbatuar zgjidhjet shkencore dhe duke matur progresin drejt objektivave.

Shkenca dhe inovacioni duke përfshirë IT-në, Bioteknologjinë, Inteligjencën Artificiale dhe Bujqësinë Dixhitale dhe të tjera, do të jenë një forcë vendimtare për transformimin e sistemeve agroushqimore.

Së fundi, të gjithë ne si kon-

sumatorë mund dhe duhet të luajmë rolin tonë në gjurmueshmërinë e produkteve ushqimore, praktikimin e stileve të shëndetshme të jetesës, ngritjen e zërit për të ndikuar në vendimmarrje, reduktimin e mbetjeve ushqimore dhe promovimin e diversitetit ushqimor.

Kjo Ditë Botërore e Ushqimit na lejon të ripërtërijmë angazhimin tonë për të ndërtuar sisteme agroushqimore më efikase, më gjithëpërfshirëse, më elastike dhe më të qëndrueshme që respektojnë të drejtën e secilit për ushqime të larmishme dhe me vlera ushqyese.

Së bashku, ne mund të kthehemi në rrugën e duhur për të arritur Axiendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm - zotimi ynë kolektiv për të ndërmarrë veprime për njerëzit, planetin dhe prosperitetin. Ne mund ta arrijmë këtë duke transformuar sistemet globale agroushqimore për të siguruar Katër më të mirat: prodhim më të mirë, ushqim më të mirë, një mjedis më të mirë dhe një jetë më të mirë - duke mos lënë askënd pas.



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



FED
invest 

**GJITHMONË
FINANCË SOCIALE**

Rritja e Kapaciteteve të Certifikimit dhe Akreditimit, një Shtyllë për Suksesin e Eksportuesve Shqiptarë

(Vijon nga faqja 3)

përfshirë sigurinë ushqimore, qëndrueshmërinë mjedisore, gjurmueshmërinë dhe mirëqenien e punonjësve, që janë parime themelore për të siguruar që produktet bujqësore plotësojnë kërkesat e tregjeve ndërkombëtare.

Ky trajnim është jetik për trupat certifikuese dhe akredituese që dëshirojnë të përmbushin standardet e tregjeve globale dhe të zgjerojnë shërbimet e tyre. GLOBALG.A.P është veçanërisht e rëndësishme për fermat dhe NVM-të që synojnë eksportin e produkteve bujqësore, pasi tregjet evropiane dhe ndërkombëtare kërkojnë që produktet të jenë të certifikuar për të garantuar sigurinë dhe gjurmueshmërinë e tyre.

Pjesëmarrësit në këtë trajnim, përfshirë ekspertë nga DPA (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit), u njohën me rregulloret dhe kriteret specifike të GLOBALG.A.P, duke përfshirë teknikat e kontrollit dhe vlerësimit të përputhshmërisë. Diskutimet përfshinë gjithashtu rolin e trupave akredituese dhe certifikuese në vlerësimin e praktikave bujqësore të fermave dhe prodhuesve shqiptarë.

Një temë thelbësore e trajtimit ishte ISO/IEC 17065, standardi ndërkombëtar për trupat certifikuese të produkteve, i cili lidhet ngushtë me procesin e certifikimit GLOBALG.A.P. Trupat certifikuese të akredituara sipas këtij standardi sigurojnë që certifikimi i praktikave bujqësore kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke rritur kështu besueshmërinë e produkteve shqiptare në tregjet globale.

Rëndësia e këtij trajnimi qëndron në ndihmën që u jep trupave certifikuese dhe fermerëve shqiptarë për të përmbushur kërkesat gjithnjë e më të rrepta të certifikimit bujqësor. Ky certifikim është një hap kyç për të siguruar qasje në tregjet ndërkombëtare, ku kërkesat për siguri dhe gjurmueshmëri janë shumë të larta.

Pjesëmarrja e DPA-së në këtë trajnim tregon angazhimin për ngritjen e kapaciteteve të akreditimit brenda Shqipërisë, duke ulur varësinë nga akreditimet ndërkombëtare dhe duke mbështetur zhvillimin e trupave certifikuese vendore. Kjo, në kombinim me rritjen e ndërgjegjësisë së fermerëve dhe NVM-ve për kërkesat e GLOBALG.A.P, ndihmon Shqipërinë të pozicionohet më mirë në tregjet ndërkombëtare për produktet bujqësore, veçanërisht për sektorët e Bimëve Aromatike dhe Mjekësore (BAM) dhe Frutave dhe Peri-meve (F&P).

Në përfundim, ky trajnim është një fazë kyçe për ndërtimin e një infrastrukture të fortë të certifikimit bujqësor,

duke hapur rrugën për zgjerimin e mundësive të eksportit dhe për të siguruar që produktet shqiptare të përputhen me standardet më të larta globale.

Ngritja e Kapaciteteve të Trupës Akredituese për GLOBALG.A.P - Një hap Strategjik për Suksesin e Eksportuesve Shqiptarë



Ngritja e kapaciteteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (DPA), për të akredituar trupa certifikuese sipas standardit ISO/IEC 17065 dhe skemës GLOBALG.A.P, është një hap strategjik për të rritur besueshmërinë dhe konkurrueshmërinë e produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare. Kjo nismë është veçanërisht kritike për sektorin bujqësor, ku siguria ushqimore, qëndrueshmëria dhe gjurmueshmëria e produkteve luajnë një rol të pazëvendësueshëm në suksesin e eksporteve.

Duke akredituar trupa certifikuese vendore sipas standardeve ndërkombëtare, DPA do të reduktojë varësinë e Shqipërisë nga trupat certifikuese të huaja, duke ulur kostot dhe kohën për certifikim për fermerët dhe NVM-të që synojnë eksportet. Kjo infrastrukturë e përmirësuar lejon që produktet shqiptare të certifikohen brenda vendit, duke krijuar një proces më të shpejtë dhe më të arritshëm për bizneset e vogla dhe të mesme bujqësore.

Trajnimet e realizuara deri më tani kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në ngritjen e kapaciteteve teknike të trupave certifikuese. GLOBALG.A.P, si një nga skemat më të rëndësishme për certifikimin e praktikave të mira bujqësore, kërkon një përgatitje të thellë në vlerësimin e përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare. Duke akredituar

trupa certifikuese për GLOBALG.A.P, Shqipëria do të jetë në gjendje të krijojë një rrjet më të fortë certifikimi, që jo vetëm përmbush kërkesat e rrepta të tregjeve ndërkombëtare, por edhe ndihmon në përmirësimin e cilësisë së prodhimit bujqësor vendas.

Kapacitetet e përmirësuara të DPA do të krijojnë mundësi të reja për eksportuesit shqiptarë, duke i ndihmuar ata të përballen më me lehtësi me kërkesat gjithnjë e më të ndërlikuara për certifikim dhe gjurmueshmëri.

Në të njëjtën kohë, ky përmirësim i kapaciteteve teknike të trupave certifikuese është thelbësor për ruajtjen e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së produkteve shqiptare. Përmes akreditimit të trupave certifikuese, DPA po vendos themelet për një sistem të fuqishëm që do të sigurojë një zinxhir të besueshëm vlerësimi të konformitetit. Kjo do të ndihmojë në rritjen e transparencës dhe integritetit të produkteve të certifikuar, duke ndihmuar Shqipërinë të ndërtojë një imazh të besueshëm në tregjet ndërkombëtare.

UNIDO për Shqipërinë - Përmirësimi i Infrastrukturës së Cilësisë dhe Mbështetja për NVM-të

Përmes mbështetjes së vazhdueshme të ofruar në kuadër të projektit GQSP Albania, mbështetur nga SECO dhe implementuar nga UNIDO, Shqipëria ka bërë përpertime të rëndësishme drejt përmirësimit të infrastrukturës së cilësisë. Ky projekt ka kontribuar në ngritjen e kapaciteteve teknike të institucioneve kyçe si Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), duke krijuar një bazë të fuqishme për akreditimin dhe certifikimin brenda vendit.

Mbështetja për një sistem të fortë të akreditimit dhe certifikimit është thelbësore për të lehtësuar proceset dhe për të ulur kostot për NVM-të dhe bizneset që operojnë në sektorë strategjikë. Me përmirësimin e kapaciteteve të DPA-së dhe me fokus të veçantë të bashkëpunimi me SME-të, Shqipëria po pozicionohet më mirë për të përmbushur kërkesat e tregjeve ndërkombëtare dhe për të rritur konkurrueshmërinë globale.

Mbështetja e UNIDO dhe SECO ka një ndikim të jashtëzakonshëm në përmirësimin e kapaciteteve teknike dhe institucionale të vendit, duke krijuar mundësi të reja për SME-të shqiptare. Kjo ndihmë garanton përfshirjen e Shqipërisë në zinxhirët globalë të vlerës dhe krijimin e një baze të fortë për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

AGROTURIZËM

Zona Pishë Poro-Nartë shpallet peizazh i mbrojtur ujor e tokësor

Këshilli i Ministrave shpalli peizazh i mbrojtur ujor e tokësor të kategorisë V zonën Pishë Poro-Nartë, me sipërfaqe 16 124.61 ha.

Përbëhet nga dy pjesë: Pishë Poro dhe Narta. Akumulimi, në zonën e Pishë Poros, aktualisht, zhvillohet në të dy anët e grykëderdhjes së kanalit kullues të Povelçës, në rreth 7 km gjatësi.

Laguna e Nartës (41,5 km²), bën pjesë në lagunat e mëdha të bregdetit tonë të Adriatikut. Në skajin jugor të lagunës ngrihen kodrat e ulëta terrigjene të Triporitit, të cilat, nëpërmjet brezit litoral, lidhen me skajin jugor të deltës së Vjosës. Ky brez litoral, i mbuluar në pjesën më të madhe me pisha, veçoi lagunën nga deti.

Në të janë dy kanale natyrore, nëpërmjet të cilave laguna e Nartës komunikon me detin. Laguna ka thellësi të vogël, mesatare 1.2 m dhe maksimalja rreth 2 m. Kodra e ulët e Zvërnecit formon një ishull në lagunë.

Pjesa veriore e lagunës është kthyer në kripore në fillimet e viteve 1950. Kriporja zë rreth 1 500 ha dhe ndahet nga laguna me argjinaturë. Përbëhet nga shumë pellgje të cekëta dhe ishuj të vegjël, të përshtatshëm për shpendët folezues të ujit. Dallohet për botë të gjallë të pasur dhe të larmishëm, ku dallohen shpendët ndenjtarë dhe shtegtarë.

Laguna e Nartës së bashku me deltën e Lumit Vjosa, Lagunën e Kallëngas dhe Kepin e Dajlanit, janë formuar nga prurjet aluvionale të Lumit të Vjosës dhe karakterizohet nga cektësia dhe përmytja herë pas hershme.

Rajoni është i njohur për florën e veçantë dhe larminë e habitateve, me vlera të veçanta shkencore, ekologjike (shumë gjallesa të rralla) dhe ekonomike (bimë mjekësore, aromatike, industriale dhe dekorative). Mendohet se në të rriten të paktën 800 bimë enësore. Takohen rreth 25 lloje bimësh

të rrezikuara. Me interes të madh cilësohet sidomos Orchis albanica dhe forma hibride Orchis paparisti, ndërsa 67 lloje cilësohen me interes ekonomik dhe shkencor.

Narta është laguna e dytë në vend për nga rëndësia për shpendët e ujit. Më të zakonshme janë rosat dhe bajzat. Gjatë sezonit të folezimit, Narta kthehet në vendin e shumimit për lloje të shumta shpendësh uji. Afro 88 % e tyre përqundrohet në kriporet. Narta është vendushqimi për pelikanin (Pelicanus crispus), por takohen rregullisht flamingot (Phenicopterus ruber).

Po ashtu qeveria shpalli peizazh të mbrojtur të kategorisë V edhe zonën "Kuturman - Qafë Bushi", me sipërfaqe 4 160.26 ha, mbështetur në vlerat natyrore, të biodiversitetit, të mbulesës vegetative, vlerat biologjike, kulturore, historike e trashëgimore, që ka në tërësi ky ekosistem natyror.

Mjedis - BE pritët të ndalojë pirjen e duhanit edhe në ambiente të jashtme

Bashkimi Europian vazhdon të intensifikojë betejën e tij kundër pirjes së duhanit, shkruan adnkronos.it.

Me një rekomandim të ri, Komisioni Evropian ka përditësuar dhe zgjeruar politikën për mjedisin pa duhan ("zonat pa duhan"), duke synuar mbrojtjen më të madhe të qytetarëve, në veçanti të fëmijëve dhe të rinjve.

Këto rekomandime nuk përfshijnë vetëm duhanin tradicional, por edhe cigaret elektronike.

Por çfarë përfshin saktësisht ky rekomandim?

Thelbi i rekomandimit të ri të Komisionit është shtrirja e ndalimit të pirjes së duhanit në zonat e jashtme ku të rinjtë dhe fëmijët janë më të pranishëm.

Këto përfshijnë hapësira të tilla si këndet e lojërave,

pishinat, ndalesat e transportit publik, zonat e jashtme të spitaleve dhe shkollave, si dhe ndërtesat publike dhe objektet e shërbimit.

Objekti i është i qartë: krijimi i mjediseve të sigurta, ku të rinjtë të mos ekspozohen ndaj efekteve të rrezikshme të pirjes pasive të duhanit,



tashmë të njohur si një nga shkaqet kryesore të problemeve respiratore dhe kardiovaskulare.

Kjo nismë nuk ndalet vetëm në cigaret tradicionale. Komisioni përfshiu në rekomandimet e tij produkte të reja në zhvillim, të tilla si cigaret elektronike dhe produktet e duhanit me ngrohje (HTP), të cilat kanë fituar një pjesë të konsiderueshme të tregut vitet e fundit, veçanërisht midis të rinjve.

Arsyeja?

Pavarësisht pretendimeve nga disa prodhues që i promovojnë këto pajisje si alternativa më pak të dëmshme, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ka theksuar rreziqet që lindin nga ekspozimi ndaj tymit të "dorës së dytë" dhe aerosoleve të emetuara nga këto produkte.

Skema Kombëtare e Investimeve 2024

MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

Nr. 1761/Prot.

Datë 18.9.2024

MINISTRIA E FINANCAVE

Nr. 12449/Prot.

Datë 24.9.2024

UDHËZIM
Nr. 22, datë 19.09.2024

PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 7.3.2024 "PËR
KRITERET, PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 6 të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", i ndryshuar, të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012 "Për peshkimin", të ndryshuar dhe të pikës 5, të VKM nr. 130, datë 6.3.2024, "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimt nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2024", të ndryshuar, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministri i Financave,

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 6, datë 7.3.2024 "Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit e bujqësisë dhe zhvillimit rural", bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në kreun I, në tabelën "Emërtimi i masës mbështetëse" pas masës me nr. 8, shtohen masat me nr. 9-13, si më poshtë:

Nr i masës	Emërtimi i masës mbështetëse
9	Për ndërtimin e serrave diellore të reja me sipërfaqe jo më pak se 0.2 ha (zero presje dy) dhe jo më shumë se 2 (dy) ha për subjekt, përfshirë edhe instalimin e sistemit të ujitjes. Masa e përfitimt të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se: <ul style="list-style-type: none"> 15,000,000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë/ha për serrat e prodhimit të perimeve; 8,000,000 (tetë milion) lekë/ha për serrat e prodhimit të rrushit për tavolinë; 4,000,000 (katër milion) lekë/ha për serrat (tunelet plastike) të prodhimit të luleshtrydheve.
10	Rrjeta për mbrojtjen e prodhimit nga breshëri në blloqet ekzistuese me pemë frutore, agrume dhe vreshta. Masa e përfitimt të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë/ha. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha dhe jo më shumë se 5 (pesë) ha;

1

24. I gjithë dokumentacioni i kërkuar më sipër kur dorëzohet si fotokopje (me përjashtim të kartës së identitetit ose pasaportës biometrike, formularit të regjistrimit në QKB të ofertuesve) të jetë i noterizuar dhe i lëshuar jo më parë se 3 muaj nga data e aplikimit.

3. Pas kreut "IV. INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM PËR APLIKIMIN", shtohet Kreu IV/I me formulimin si më poshtë:

"IV/I. APLIKIMI PËR MASAT MBËSHTETËSE TË INVESTIMEVE

- a. Informacioni i nevojshëm për mënyrën e aplikimit, kriteret e përfitimt dhe procedurit deri në përfitimt e mbështetjes financiare gjendet pranë Agropikave, pranë Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, Zyrave Qendrore të AZHBR si dhe në faqen e internetit: www.azhbr.gov.al dhe www.mbzhr.gov.al.
- b. Aplikimet për masat mbështetëse të investimeve me nr. 9-13 do të bëhen me dosje fizike në zyrat qendrore të AZHBR;
- c. Për qëllime identifikimi, aplikanti sipas statusit përkatës (fermer individual / person fizik / juridik), ose përfaqësuesi i tij me prokurë ose autorizim, duhet të paraqitet në zyrat qendrore të AZHBR-së me letërnjoftim elektronik ose pasaportë biometrike.
- d. Aplikimet për masat mbështetëse të investimeve do të bëhen nga data 30.9.2024 deri më 8.11.2024, brenda orarit zyrtar.
- e. Nëse fondi i planifikuar për masat mbështetëse të investimeve nuk ezaurohet me thirrjen e parë në afatin e mësipërm, mund të shpallen edhe thirrje të tjera, në data të miratuara nga ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural".

4. Në kreun V. "DOKUMENTACIONI QË GJENEROHET NGA REGJISTRAT ELEKTRONIK DHE MODULI I PUNONJËSVE QEVERITAR":

- a. Pas pikës 8, shtohet pika 9 me formulimin si më poshtë:
"Për masat e investimeve 9-13, Formulari i aplikimit për masën mbështetëse përkatëse, i printuar, vihet në dispozicion nga AZHBR, sipas Aneksit 10, të këtij udhëzimi";
- b. Pas pikës 9, në paragrafin e parë, pas fjalëve "Aplikantët, për masat mbështetëse" shtohen fjalët "nr. 1-8";
- c. Para fjalisë së fundit "Mosplotësimi i kriterëve të përfitueshmërisë brenda afatit të përcaktuar, është kriter kualifikimi", shtohet paragrafi me formulimin e mëposhtëm:

"Për masat e investimeve 9-13 nëse ndonjë dokument nuk arrihet të gjenerohet nga regjistrat zyrtarë, aplikantët informohen zyrtarisht nga AZHBR me shkresë për plotësim dokumentacioni, i cili dorëzohet nga aplikanti në AZHBR jo më vonë se 45 ditë kalendrike nga afati i përfundimit të aplikimeve".

5. Në kreun VI dhe kreun VII togfjalëshi "datës 31 korrik 2024" zëvendësohet kudo me togfjalëshin "datës 31 tetor 2024".

3

11	Për ndërtimin e ambienteve për mbarëshkrimin e kafshëve dhe stabilimenteve për rritjen e shpendëve, me kapacitet jo më pak se 10 (dhjetë) lopë, jo më pak se 100 (njëqind) të imta, jo më pak se 10 (dhjetë) dosa dhe jo më pak se 10,000 (dhjetë mijë) shpendë. Masa e përfitimt të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 15,000,000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë për subjekt;
12	Për blerjen e traktorëve, makinerive dhe pajisjeve për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat bujqësore dhe blegtorale. Masa e përfitimt të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5,000,000 (pesë milion) lekë për subjekt;
13	Mbështetje për akuakulturën detare për koshat e rritjes së peshkut (vetëm për koshat dhe rrjetat). Masa e përfitimt të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 20,000,000 (njëzet milion) lekë për subjekt."

2. Në kreun III, "KRITERE TË PËRGJITHSHME TË PËRFITIMIT":

- a. Pika 1, shfuqizohet.
- b. Në fund të pikës 4 shtohet togfjalëshi "sipas fushës së veprimtarisë që përfshin aktivitetin për të cilin aplikojnë".
- c. Në pikën 12, pas fjalëve "masat mbështetëse" shtohet fjala "direkte".
- ç. Pas pikës 15, shtohet pika 16 me formulimin si më poshtë:
"Për masat mbështetëse 9-13 aplikanti":
- nuk duhet të jetë debitor ndaj AZHBR dhe MBZHR;
- nuk duhet të jetë debitor ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas legjislacionit në fuqi;
- të ketë shlyer "sigurimet shoqërore" në rastin e fermerëve individualë;
- të ketë tokën në pronësi dhe/ose me qira/ huapërdorje për të paktën 5 vjet, duke filluar nga viti i aplikimit.
- të ketë lejen përkatëse të ndërtimit sipas legjislacionit në fuqi, para lidhjes së kontratës;

- d. Pas pikës 16 shtohen pikat me formulimin si më poshtë:

- "17. Për ofertat në valutë të huaj do të zbatohet kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e hapjes së aplikimit;
18. Për masat mbështetëse të investimeve, punimet e ndërtimit, pajisjet, makinerite dhe faturat/aktet e zhdoganimit duhet të jenë pas datës së lidhjes së kontratës;
19. Të gjitha mallrat, makineritë dhe pajisjet duhet të jenë të reja dhe të papërdorura;
20. Financimi për masat 9-13 do të bëhet deri në vlerën e tregut të përlogarit nga AZHBR, pa TVSH. Vlera e përlogarit do të kryhet duke u bazuar në arsyeshmërinë e çmimeve sipas kërkit të tregut dhe/ose çmimeve të referencës së databazës së çmimeve të AZHBR;
21. Në rastet kur vlera e investimit të pranueshëm (pa TVSH) është mbi 5 milion lekë, aplikanti duhet të dorëzojë planin e biznesit sipas Aneksit 11 dhe 11.1, të këtij udhëzimi;
22. Aplikanti mund të aplikojë dhe përfitojë vetëm në 1 (një) nga masat mbështetëse 9-13;
23. Përfituesve nga masat e mbështetjes së investimeve 9-13, pas lidhjes së kontratës u paguhet paraprakisht deri në 30% të masës së financimit të kontraktuar, kundrejt garancisë së pagesës së lëshuar nga shoqëri sigurimi dhe/ose banka sipas përcaktimeve të kontratës. Kërkesa për parapagesë duhet të depozitohet pranë AZHBR brenda një afati 15 ditë pune nga lidhja e kontratës;

2

6. Në kreun VI, "KRITERET SPECIFIKE DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR MASAT MBËSHTETËSE":

- a. Emërtesa e kreut zëvendësohet me formulimin "VI. KRITERET SPECIFIKE DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR MASAT MBËSHTETËSE NR. 1-7".
- b. Në masen 1, 2, 3, nëndarja "ii", shkronja "b" dhe në masën 4 dhe 5, nëndarja "ii", shkronja "d", zëvendësohen me formulimin e mëposhtëm:
"Marrëveshja e dakordësisë/bashkimit të anëtarëve të grup fermerëve, e nënshkruar sipas marrëveshjes tip në Aneksin 2 (M1-3). Marrëveshja dorëzohet fizikisht në rast se nuk është ngarkuar në sistem".
- c. Në masen 1, 2, 3, nëndarja "ii", shkronja "c" dhe në masen 5, nëndarja "ii", shkronja "e", zëvendësohen me formulimin e mëposhtëm:
"Kontrata për shitjen e qumështit/mjaltit/bimëve mjekësore e aromatike midis grupit të fermerëve dhe një subjekti të licencuar grumbullues/përpunues të qumështit/mjaltit/bimëve mjekësore e aromatike, sipas Aneksit 3. Kontrata dorëzohet fizikisht në rast se nuk është ngarkuar në sistem".

7. Pas kreut VIII. "KRITERET, DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR MASËN 8" shtohet Kreu VIII/I me formulimin si më poshtë:

"VIII/I. KRITERET SPECIFIKE DHE DOKUMENTACIONI PËR MASAT MBËSHTETËSE NR. 9-13

Gjatë periudhës së aplikimit, aplikanti sjell në AZHBR të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas masave përkatëse. Dokumentacioni i mbyllur në zarf, dorëzohet me protokoll në adresën: Rruga "Muhamet Gjollësja, nr. 56 Tiranë".

1. **Shpenzime të papranueshme:**
- Blerje e gjësë së gjallë, truallit apo ndërtesës;
- Shpenzimet e përgjithshme si hartimi i biznesplanit, tarifat e inxhinierëve, arkitektëve, studime fizibiliteti, patenta, licenca, etj;
- Shpenzime operative si transporti i makinerive dhe linjave të ndryshme, elektriciteti, uji, gazi, mirëmbajtje, amortizim dhe kostot e qirasë, etj;
- Detyrimet doganore dhe të importit ose çdo tarifë që ka efekt të njëjtë;
- Blerje, qira ose lizing për tokën apo ndërtesat ekzistuese;
- Gjoha apo detyrime gjyqësore;
- Kostot operative të aktivitetit;
- Mallra, makineri dhe pajisje të përdorura;
- Detyrime bankare si kosto garancish e të tjera të ngjashme;
- Kontributet në natyrë;
- Kosto të shkëmbimit valutor;
- Shpenzime të kryera në objekt para lidhjes së kontratës me AZHBR-në;
- Kosto promovimi për të bërë publik produktin;
- Aplikanti i cili ka dhe menaxhon mbi 25% kapital publik në sipërmarrjen e vet;
- TVSH.

4

Skema Kombëtare e Investimeve 2024

KRITERET SPECIFIKE TË PËRFITIMIT, KRITERET KONKURRUESE DHE DOKUMENTACIONI

Masa 9. Për ndërtimin e serrave diellore të reja me sipërfaqe jo më pak se 0.2 ha (dy dynym) dhe jo më shumë se 2 (dy) ha për subjekt, përfshirë edhe instalimin e sistemit të ujitjes.

Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se:

- 15,000,000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë/ha për serrat e prodhimit të perimeve;
- 8,000,000 (tetë milion) lekë/ha për serrat e prodhimit të rrushit për tavolinë;
- 4,000,000 (katër milion) lekë/ha për serrat (tunelet plastike) të prodhimit të luleshtrydheve.

i. Kriteret specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Fermer individual, subjekt me status fizik/ juridik, SHBB;

- Aplikanti, me status person fizik/juridik, duhet të jetë i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për fushën e veprimtarisë së pranueshme për të cilën aplikon në Qendrën Kombëtare të Biznesit si dhe me status aktiv;
- Investimet në ndërtimin e serrave diellore të reja përfshijnë në çdo rast sistemin e ujitjes;
- Për investime mbi 5 milion lekë, të ketë plan biznesin e detajuar për 5 vjet, sipas modelit standard, të përcaktuar në Aneksin 11 dhe 11.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi:
 - NPV, duhet të dalë ≥ 0 .
 - IRR duhet të dalë $\geq 1\%$
 - Në rast të informacioneve/dokumentacionit të paqartë/pasaktë, AZHBR gëzon të drejtën të kërkojë me shkrim informacion shtesë. Nëse nuk arsyetohen dhe mbështeten informacionet/dokumentacionet me të dhëna faktike të qarta, atëherë ky aplikim skualifikohet.
 - Në rast se nuk plotësohen këto kritere, ose nuk është plotësuar plan biznesi standard sipas Aneksit 11 dhe 11.1, aplikimi skualifikohet;
- Aplikanti të ketë projektin arkitektonik, preventivin për punimet civile dhe planvendosjen për ndërtimin e serrës;
- Plasmasi të jetë i shoqëruar me certifikatën/dokumentin e garancisë, për jo më pak se 3 vjet;
- Mallrat, sistemet/pajisjet duhet të jenë të reja;
- Toka të jetë në pronësi dhe/ose me qira/ huapërdorje për të paktën 5 vjet, duke filluar nga viti i aplikimit dhe jo më pak se 0.2 ha;
- Të ketë lejen e ndërtimit / deklarimin paraprak sipas legjislacionit në fuqi;
- Aplikanti nuk duhet të jetë debitor ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas legjislacionit në fuqi;
- Aplikanti nuk duhet të jetë debitor ndaj AZHBR dhe MBZHR;
- Aplikanti nuk duhet të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;
- Aplikanti nuk duhet të jetë kredimarrës me status 3 dhe/ose 4 sipas Raportit të Kredimarrësit;
- Në rastet kur sipërfaqja e aplikuar është më e madhe se 2 ha, aplikimi do të pranohet për t'u financuar deri në masën 2 ha për subjekt, me kusht që pjesa tjetër e investimit të propozuar të mbulohet nga aplikanti me fondet e veta;
- Investimi nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës.

5

aplikimit. Për fermerët individualë vërtetim për shlyerjen e sigurimeve shoqërore nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;

- Dokumenti i pronësisë së tokës ose qirasë, për të paktën 5 vjet duke filluar nga viti i aplikimit:
 - Certifikata e pronësisë, harta treguese dhe kartela e rifreskuar e pasurisë së paluajtshme (kartela duhet të jetë lëshuar jo më herët se 3 muaj para aplikimit);
 - Vërtetimi i pronësisë shoqëruar me hartën treguese lëshuar nga ASHK (në zonat ku azhurnimi nuk ka përfunduar ende ose është në proces);
 - Akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP), sipas legjislacionit për ndarjen e tokës bujqësore, bashkëlidhur me fragmentin e hartës kadastrale, që konfirmohet nga ASHK. Nëse AMTP nuk konfirmohet nga ASHK, AZHBR kërkon konfirmim zyrtar të këtij dokumenti me sipërfaqen totale dhe sipërfaqen e parcelave nga njësia administrative/bashkia përkatëse.

Në rastin e dorëzimit të AMTP-së duhet të dorëzohet certifikatë familjare e gjendjes më 1.8.1991 shoqëruar me Formularin tip të dakordësisë së anëtarëve të familjes bujqësore, sipas Aneksit 8.1. Marrëveshja duhet të jetë e firmosur nga të gjithë anëtarët sipas gjendjes aktuale. Nëse ka ndryshime midis gjendjes së certifikatës së 1.8.1991 me gjendjen e certifikatës aktuale atëherë marrëveshja duhet të shoqërohet me dokumentacionin plotësues sipas rastit dhe sipas legjislacionit në fuqi. Marrëveshja duhet për një afat të paktën 5 vjet, duke filluar nga viti i aplikimit.

Kur aplikanti merr tokë me qira/huapërdorje :

- Fotokopje e kontratës së transferimit të të drejtave të përdorimit (kontratë qiraje, huapërdorje) me një kohëzgjatje minimale të paktën 5 vjet pas datës së aplikimit, me vërtetim noterial shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë;
- Fotokopje e kontratës së qirasë (kontratë/kontratë tip) të lidhur me strukturat publike me një kohëzgjatje minimale të paktën 5 vjet pas datës së aplikimit shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë përkatëse.

iv. Dokumentacioni dhe kërkesa për financim

Sipas llojit të investimit, aplikanti paraqet pranë AZHBR-së kërkesën për financim. Financimi do të realizohet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Së bashku me kërkesën për financim, aplikanti paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formularin e kërkesës për pagesë sipas Aneksit 16;
- Regjistrin e plotësuar/ përditësuar të fermës;
- Situacionin e punimeve, shoqëruar me librezën e masave (për punimet e ndërtimit);
- Faturën/faturat tatimore, shoqëruar me specifikimet teknike të elementeve përkatëse dhe vlerën e elementeve përbërës sipas kontratës;
- Akt zhdoganimit për mallrat/pajisjet që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën e elementeve përbërës;
- Transaksionin bankar, dhe/ose SWIFT-in (për pagesat ndërkombëtare) për të gjitha pagesat, që vërteton transferimin e fondeve nga aplikanti tek shitësi;
- Certifikatën/dokumentin e garancisë së plasmasit me jetëgjatësi jo më pak se 3 vjet;
- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka përmbyshur detyrimet. Për fermerët individualë vërtetim për shlyerjen e sigurimeve shoqërore nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë;
- Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare, me firmë dhe vulë të njomë.

7

ii. Kriteret konkurruese

- Sipërfaqja e serrës	75 pikë
- Moshë e aplikantit	25 pikë
TOTALI	100 pikë

Vlerësimi i aplikimeve:

Për sipërfaqen (Max 75 pikë):

Vlerësimin maksimal për sipërfaqen e fiton aplikimi me sipërfaqen maksimale të lejueshme (2 ha), të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me këtë sipërfaqe.

Aplikimet me sipërfaqe më të vogla se 2 ha llogariten në mënyrë proporcionale sipas formulës:

$X = \text{Sipërfaqja për të cilën aplikon (në dynym)} * 75 / \text{sipërfaqen maksimale (20 dynym)}$.

Moshë e aplikantit (25 pikë):

Marrin 25 pikë aplikantët të cilët në datën e aplikimit janë nën 40 vjeç. Për personat juridikë pikëzimi do të bëhet duke llogaritur moshën e aksionerëve.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në AZHBR

Bashkëngjitur me kërkesën për aplikim aplikanti duhet të dorëzojë dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formulari i aplikimit sipas Aneksit 10;
- Dokumentin e regjistrimit në QKB që vërteton statusin e aplikantit (subjekt me status fizik, juridik, SHBB), nëse nuk gjenerohet nga sistemi;
- Plan biznesi i printuar dhe në CD i detajuar për 5 vjet, sipas modelit standard, të përcaktuar në Aneksin 11 dhe 11.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- Dëshminë e penalitetit për aplikantët me status fermer dhe person fizik dhe për aksionerët për aplikantët me status juridik, SHBB;
- Raporti i kredimarrësit nga Banka e Shqipërisë/banka të nivelit të dytë për aplikantin (për personin në rastin e fermerit dhe personit fizik dhe në emrin e subjektit në rastet e personave juridikë, SHBB);
- Dokumenti origjinal ose fotokopje e noterizuar e lejes së ndërtimit/miratim i deklaratës paraprake/njoftim punimesh, sipas legjislacionit në fuqi. Ky dokument mund të dorëzohet deri para lidhjes së kontratës;
- 1 ofertë origjinale sipas Aneksit 12 për serrat e prodhimit të perimeve, Aneksit 12.1 për serrat e prodhimit të rrushit për tavolinë dhe Aneksit 12.2 për serrat (tunelet plastike) të prodhimit të luleshtrydheve, shoqëruar me datë, firmë, deklaratën për jetëgjatësinë e plasmasit, vlefshmërinë e ofertës, e firmosur dhe vulosur të shoqëruar me formularin e regjistrimit në QKB (regjistrimi duhet të përfshijë aktivitetin për të cilin do të jepet oferta) të subjektit ofertues. Oferta për punimet civile duhet sipas "Hartim preventivi nga Manuali i çmimeve në ndërtim". Nëse projekti i propozuar do të realizohet nga subjekte të ndryshme për komponentë të ndryshëm të investimit, atëherë duhet të dorëzohet nga një ofertë sipas kritereve të këtij paragrafi, nga secili subjekt për komponentin që do të realizojë. Ofertuesit/t nuk duhet të jetë/jenë në konflikt interesi me njeri tjetër dhe me aplikantin;
- Projekti arkitektonik i serrës, planvendosja e serrës, preventivi për punimet civile nga personi i licencuar, si dhe i gjeneruar sipas "Hartim preventivi nga manuali i çmimeve në ndërtim" nga e-Albania (bashkëngjitur licenca e arkitektit dhe/ose inxhinierit);
- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka përmbyshur detyrimet. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit të

6

Masa 10. Rrjeta për mbrojtjen e prodhimit nga breshëri në blloqet ekzistuese me pemë frutore, agrume dhe vreshta. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë/ha. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha dhe jo më shumë se 5 (pesë) ha.

i. Kriteret specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Fermer individual, subjekt me status fizik/ juridik, SHBB;

- Aplikanti, me status person fizik/juridik, duhet të jetë i regjistruar për fushën e veprimtarisë së pranueshme për të cilën aplikon në Qendrën Kombëtare të Biznesit si dhe me status aktiv;
- Për investime mbi 5 milion lekë, të ketë plan biznesin e detajuar për 5 vjet, sipas modelit standard, të përcaktuar në Aneksin 11 dhe 11.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi:
 - NPV, duhet të dalë ≥ 0
 - IRR duhet të dalë $\geq 1\%$
 - Në rast të informacioneve/dokumentacionit të paqartë/pasaktë, AZHBR gëzon të drejtën të kërkojë me shkrim informacion shtesë. Nëse nuk arsyetohen dhe mbështeten informacionet/dokumentacionet me të dhëna faktike të qarta, atëherë ky aplikim skualifikohet.
 - Në rast se nuk plotësohen këto kritere, ose nuk është plotësuar plan biznesi standart sipas Aneksit 11 dhe 11.1, aplikimi skualifikohet;
- Aplikanti të ketë planin e vendosjes për vendosjen e rrjetave, sipas Aneksit 15;
- Rrjeta të jetë e shoqëruar me certifikatën/dokumentin e garancisë jo më pak për 5 vjet;
- Mallrat, rrjetat duhet të jenë të reja;
- Toka të jetë në pronësi dhe/ose me qira/ huapërdorje për të paktën 5 vjet, duke filluar nga viti i aplikimit dhe jo më pak se 1 ha;
- Toka ku do të kryhet investimi mund të jetë në bllok ose jo, me kusht që të jetë brenda ndarjes administrative territoriale bashki;
- Aplikanti nuk duhet të jetë debitor ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas legjislacionit në fuqi;
- Aplikanti nuk duhet të jetë debitor ndaj AZHBR dhe MBZHR;
- Aplikanti nuk duhet të jetë i dënuar për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;
- Aplikanti nuk duhet të jetë kredimarrës me status 3 dhe/ose 4 sipas Raportit të Kredimarrësit;
- Në rastet kur sipërfaqja e aplikuar është më e madhe se 5 ha, aplikimi do të pranohet për t'u financuar deri në masën 5 ha për subjekt, me kusht që pjesa tjetër e investimit të propozuar të mbulohet nga aplikanti;
- Investimi nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës.

ii. Kriteret konkurruese

- Sipërfaqja e pemtores/agrumeve /vreshtave	75 pikë
- Moshë e aplikantit	25 pikë
TOTALI	100 pikë

Vlerësimi i aplikimeve:

Për sipërfaqen (Max 75 pikë):

Vlerësimin maksimal për sipërfaqen e fiton aplikimi me sipërfaqen maksimale të lejueshme (5 ha), të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me këtë sipërfaqe.

Aplikimet me sipërfaqe më të vogla se 5 ha llogariten në mënyrë proporcionale sipas formulës:

8

Skema Kombëtare e Investimeve 2024

X = Sipërfaqja për të cilën aplikon (në dynym)*75/ sipërfaqen maksimale (50 dynym).

Mosha e aplikantit (25 pikë):

Marrin 25 pikë aplikantët të cilët në datën e aplikimit janë nën 40 vjeç. Për personat juridikë pikëzimi do të bëhet duke llogaritur moshën e aksionerëve.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në AZHBR

- Formulari i aplikimit sipas Aneksit 10;
- Dokumentin e regjistrimit në QKB që vërteton statusin e aplikantit (subjekt me status fizik, juridik, SHBB), nëse nuk gjenerohet nga sistemi;
- Plan biznesi i printuar dhe në CD i detajuar për 5 vjet, sipas modelit standard, të përcaktuar në Aneksin 11 dhe 11.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- Dëshminë e penalitetit për aplikantët me status fermer dhe person fizik dhe për aksionerët për aplikantët me status juridik, SHBB;
- Raporti i kredimarrësit nga Banka e Shqipërisë/ banka të nivelit të dytë për aplikantët (për personin në rastin e fermerit dhe personit fizik dhe në emrin e subjektit në rastet e personave juridikë, SHBB);
- 1 ofertë origjinale sipas Aneksit 13, shoqëruar me datë, firmë, deklaratën për jetëgjatësinë e rrjetës, vlefshmërinë e ofertës, e firmosur dhe vulosur të shoqëruar me formularin e regjistrimit në QKB (regjistrimi duhet të përfshijë aktivitetin për të cilin do të jepet oferta) të subjektit ofertues. Nëse projekti i propozuar do të realizohet nga subjekte të ndryshme për komponentë të ndryshëm të investimit, atëherë duhet të dorëzohet nga një ofertë sipas kriterëve të këtij paragrafi, nga secili subjekt për komponentin që do të realizojë. Ofertuesi/t nuk duhet të jetë/jenë në konflikt interesi me njeri tjetrin dhe me aplikantët;
- Planvendosjen/t e ngastrës/ve në të cilat do të instalohet rrjeta sipas Aneksit 15 (skicën e projektit);
- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka përbushur detyrimet. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit e dorëzimit të aplikimit. Për fermerët individualë vërtetim për shlyerjen e sigurimeve shoqërore nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
- Dokumenti i pronësisë së tokës ose qirasë, për të paktën 5 vjet duke filluar nga viti e aplikimit:
 - Certifikata e pronësisë, harta treguese dhe kartela e rifreskuar e pasurisë së paluajtshme (kartela duhet të jetë lëshuar jo më herët se 3 muaj para aplikimit);
 - Vërtetimi i pronësisë shoqëruar me hartën treguese lëshuar nga ASHK (në zonat ku azhormimi nuk ka përfunduar ende ose është në proces);
 - Akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP), sipas legjislacionit për ndarjen e tokës bujqësore, bashkëlidhur me fragmentin e hartës kadastrale, që konfirmohet nga ASHK. Nëse AMTP nuk konfirmohet nga ASHK, AZHBR kërkon konfirmim zyrtar të këtij dokumenti me sipërfaqen totale dhe sipërfaqen e parcelave nga njësia administrative/bashkia perkatese.

Në rastin e dorëzimit të AMTP-së duhet të dorëzohet certifikatë familjare e gjendjes më 1.8.1991 shoqëruar me Formularin tip të dakordësisë së anëtarëve të familjes bujqësore, sipas Aneksit 8.1. Marrëveshja duhet të jetë e firmosur nga të gjithë anëtarët sipas gjendjes aktuale. Nëse ka ndryshime midis gjendjes së certifikatës së 1.8.1991 me gjendjen e certifikatës aktuale atëherë marrëveshja duhet të shoqërohet me dokumentacionin plotësues sipas rastit dhe sipas legjislacionit në fuqi. Marrëveshja duhet për një afat të paktën 5 vjet, duke filluar nga viti i aplikimit.

Kur aplikanti merr tokë me qira/huapërdoreje :

- Fotokopje e kontratës së transferimit të të drejtave të përdorimit (kontratë qiraje, huapërdoreje) me një kohëzgjatje minimale të paktën 5 vjet pas datës së aplikimit, me vërtetim noterial shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë;

9

- Në rast se nuk plotësohen këto kriterë, ose nuk është plotësuar plan biznesi standart sipas Aneksit 11 dhe 11.1, aplikimi skualifikohet;
- Të ketë lejen e ndërtimit si dhe dokumentacionin (projekte, preventiv) shoqëruar për lejen e ndërtimit, sipas legjislacionit në fuqi;
 - Trualli/toka që do të përdoret për investimet, të jetë në pronësi dhe/ose me qira/ huapërdoreje për të paktën 5 vjet, duke filluar nga viti i aplikimit ;
 - Në momentin e kërkesës për pagesë subjekti duhet të ketë përfunduar investimin në ambiente për mbarëshkrimin e kafshëve dhe stabilimenteve për rritjen e shpendëve, me kapacitet jo më pak se 10 (dhjetë) lopë, jo më pak se 100 (njëqind) të imta, jo më pak se 10 (dhjetë) doka dhe jo më pak se 10,000 (dhjetë mijë) shpendë, si dhe të ketë prezent në objekt numrin e kafshëve/ shpendëve, të regjistruar në regjistrin RUDA;
 - Mallrat, sistemet/pajisjet duhet të jenë të reja;
 - Aplikanti nuk duhet jetë debitor ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas legjislacionit në fuqi;
 - Aplikanti nuk duhet të jetë debitor ndaj AZHBR dhe MBZHR;
 - Aplikanti nuk duhet të jetë dënuar me vendim të formës së prerë për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;
 - Aplikanti nuk duhet të jetë kredimarrës me status 3 dhe/ose 4 sipas Raportit të Kredimarrësit;
 - Investimi nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës.

ii. Kriteret konkurruese

- Vlera e investimit	75 pikë
- Mosha e aplikantit	25 pikë
TOTALI	100 pikë

Vlerësimi i aplikimeve:

Vlera maksimale e investimit (75 pikë):

Vlerësimin maksimal e merr aplikanti i cili do të realizojë investime me vlerë 30 milion lekë, të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me këtë vlerë.

Aplikimet me vlerë më të vogël llogariten në mënyrë proporcionale sipas formulës:

$$X = \text{Vlera për të cilën aplikon} * 75 / \text{Vlera maksimale } 30 \text{ milion.}$$

Mosha e aplikantit (25 pikë):

Marrin 25 pikë aplikantët të cilët në datën e aplikimit janë nën 40 vjeç. Për personat juridikë pikëzimi do të bëhet duke llogaritur moshën e aksionerëve.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në AZHBR

- Formulari i aplikimit sipas Aneksit 10;
- Plan biznesi i printuar dhe në CD i detajuar për 5 vjet, sipas modelit standard, të përcaktuar në Aneksin 11 dhe 11.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- Dokumentin e regjistrimit në QKB që vërteton statusin e aplikantit (subjekt me status fizik, juridik, SHBB), nëse nuk gjenerohet nga sistemi;
- Dëshminë e penalitetit për aplikantët me status fermer dhe person fizik dhe për aksionerët për aplikantët me status juridik, SHBB;
- Raporti i kredimarrësit nga Banka e Shqipërisë/ banka të nivelit të dytë për aplikantët (për personin në rastin e fermerit dhe personit fizik dhe në emrin e subjektit në rastet e personave juridikë, SHBB);

11

- Fotokopje e kontratës së qirasë (kontratë/kontratë tip) të lidhur me strukturat publike me një kohëzgjatje minimale të paktën 5 vjet pas datës së aplikimit shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë përkatës.

iv. Dokumentacioni dhe kërkesa për financim

Sipas llojit të investimit, aplikanti paraqet pranë AZHBR-së kërkesën për financim. Financimi do të realizohet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Së bashku me kërkesën për financim, aplikanti paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formularin e kërkesës për pagesë sipas Aneksit 16;
- Regjistrin e plotësuar/përditësuar të fermës;
- Faturën/faturat tatimore, shoqëruar me specifikimet teknike të elementëve përkatës dhe vlerën e elementëve përbërës sipas kontratës;
- Akt zhdoganimit për mallrat/pajisjet që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën e elementëve përbërës;
- Transaksionin bankar, dhe/ose SWIFT-in (për pagesat ndërkombëtare) për të gjitha pagesat, që vërteton transferimin e fondeve nga aplikanti tek shitësi (ofertuesi);
- Certifikatën/dokumentin e garancisë së rrjetës;
- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka përbushur detyrimet. Për fermerët individualë vërtetim për shlyerjen e sigurimeve shoqërore nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë;
- Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare, me firmë dhe vulë të njomë.

Masa 11. Për ndërtimin e ambienteve për mbarëshkrimin e kafshëve dhe stabilimenteve për rritjen e shpendëve, me kapacitet jo më pak se 10 (dhjetë) lopë, jo më pak se 100 (njëqind) të imta, jo më pak se 10 (dhjetë) doka dhe jo më pak se 10,000 (dhjetë mijë) shpendë. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 15,000,000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë për subjekt.

i. Kriteret specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Fermer individual, subjekt me status fizik/ juridik, SHBB.

- Janë të pranueshme investimet për ndërtimin e ambienteve për kafshët/shpendët dhe sisteme, pajisje në funksion të proceseve të pirjes së ujit, të ushqyerit dhe largimit/depozitimit të jashtëqitjeve si dhe sistemet e monitorimit të shpendëve;
- Aplikanti, me status person fizik/juridik, duhet të jetë i regjistruar për fushën e veprimtarisë së pranueshme për të cilën aplikon në Qendrën Kombëtare të Biznesit si dhe me status aktiv;
- Për investimet e përfshira në këto masa, aplikanti duhet të jetë i pajisur me licencat e kërkuara sipas legjislacionit në fuqi;
- Për investime mbi 5 milion lekë, të ketë plan biznesin e detajuar për 5 vjet, sipas modelit standard, të përcaktuar në Aneksin 11 dhe 11.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi:
 - NPV, duhet të dalë ≥ 0
 - IRR duhet të dalë $\geq 1\%$
 - Në rast të informacioneve/dokumentacionit të paqartë/pasaktë, AZHBR gëzon të drejtën të kërkojë me shkrim informacion shtesë. Nëse nuk arsyetohen dhe mbështeten informacionet/dokumentacionet me të dhëna faktike të qarta, atëherë ky aplikim skualifikohet.

10

- Dokumenti original ose fotokopje e noterizuar e lejes së ndërtimit/miratim i deklaratës paraprake sipas legjislacionit në fuqi. Ky dokument mund të dorëzohet edhe para lidhjes së kontratës;
 - 1 ofertë origjinale shoqëruar me datë, firmë, vlefshmërinë e ofertës, deklaratë për kapacitetin e stallës /stabilimentit, e firmosur, dhe vulosur të shoqëruar me formularin e regjistrimit në QKB (regjistrimi duhet të përfshijë aktivitetin për të cilin do të jepet oferta) të subjektit ofertues. Oferta për punimet civile duhet sipas "Hartim preventivi nga Manuali i çmimeve në ndërtim". Nëse projekti i propozuar do të realizohet nga subjekte të ndryshme për komponentë të ndryshëm të investimit, atëherë duhet të dorëzohet nga një ofertë sipas kriterëve të këtij paragrafi, nga secili subjekt për komponentin që do të realizojë. Ofertuesi/t nuk duhet të jetë/jenë në konflikt interesi me njeri tjetrin dhe me aplikantët;
 - Planvendosje e strukturës së projektit/ leja zhvillimore, preventivi nga personi i licencuar, si dhe i gjeneruar sipas "Hartim preventivi nga manuali i çmimeve në ndërtim" nga e-Albania, projekti konstruktiv, projekti arkitekturor, projektet elektrike/hidraulike/MKZ si dhe relacionet përkatëse. Projektet duhet të shoqërohen me licencat përkatëse të arkitektëve/ inxhinierëve;
 - Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka përbushur detyrimet. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit e dorëzimit të aplikimit. Për fermerët individualë vërtetim për shlyerjen e sigurimeve shoqërore nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
 - Dokumenti i pronësisë së tokës ose qirasë, për të paktën 5 vjet duke filluar nga viti e aplikimit:
 - Certifikata e pronësisë, harta treguese dhe kartela e rifreskuar e pasurisë së paluajtshme (kartela duhet të jetë lëshuar jo më herët se 3 muaj para aplikimit);
 - Vërtetimi i pronësisë shoqëruar me hartën treguese lëshuar nga ASHK (në zonat ku azhormimi nuk ka përfunduar ende ose është në proces);
 - Akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP), sipas legjislacionit për ndarjen e tokës bujqësore, bashkëlidhur me fragmentin e hartës kadastrale, që konfirmohet nga ASHK. Nëse AMTP nuk konfirmohet nga ASHK, AZHBR kërkon konfirmim zyrtar të këtij dokumenti me sipërfaqen totale dhe sipërfaqen e parcelave nga njësia administrative/bashkia perkatese.
- Në rastin e dorëzimit të AMTP-së duhet të dorëzohet certifikatë familjare e gjendjes më 1.8.1991 shoqëruar me Formularin tip të dakordësisë së anëtarëve të familjes bujqësore Aneksi 8.1. Marrëveshja duhet të jetë e firmosur nga të gjithë anëtarët sipas gjendjes aktuale. Nëse ka ndryshime midis gjendjes së certifikatës së 1.8.1991 me gjendjen e certifikatës aktuale atëherë marrëveshja duhet të shoqërohet me dokumentacionin plotësues sipas rastit dhe sipas legjislacionit në fuqi. Marrëveshja duhet për një afat të paktën 5 vjet, duke filluar nga viti i aplikimit.

Kur aplikanti merr tokë me qira/huapërdoreje :

- Fotokopje e kontratës së transferimit të të drejtave të përdorimit (kontratë qiraje, huapërdoreje) me një kohëzgjatje minimale të paktën 5 vjet pas datës së aplikimit, me vërtetim noterial shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë;
- Fotokopje e kontratës së qirasë (kontratë/kontratë tip) të lidhur me strukturat publike me një kohëzgjatje minimale të paktën 5 vjet pas datës së aplikimit shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë përkatës.

iv. Dokumentacioni dhe kërkesa për pagesë

Sipas llojit të investimit, aplikanti paraqet pranë AZHBR-së kërkesën për financim. Financimi do të realizohet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Së bashku me kërkesën për financim, aplikanti paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formularin e kërkesës për pagesë sipas Aneksit 17 ;
- Lejen e shfrytëzimit për objektin e investimit;
- Regjistrin e plotësuar/ përditësuar të fermës;

12

Skema Kombëtare e Investimeve 2024

- d. Regjistrin RUDA i cili vërteton numrin e kafshëve/shpendëve;
- e. Kontratën me sipërmarrësin e punimeve;
- f. Situacionin e punimeve të kryera me faturën tatimore shoqëruar me librezën e masave (për ndërtim);
- g. Faturën/faturat tatimore për ndërtimin dhe sistemet/ pajisjet, shoqëruar me specifikimet teknike të elementeve përkatës dhe vlerën e elementëve përbërës sipas kontratës;
- h. Akt zhdoganimit për sistemet/mjetet/pajisjet që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën ekonomike të elementëve përbërës;
- i. Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka përbushur detyrimet. Për fermerët individualë vërtetim për shlyerjen e sigurimeve shoqërore nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë;
- j. Transaksionin bankar, dhe/ose SWIFT-in (për pagesat ndërkombëtare) për të gjitha pagesat, që vërteton transferimin e fondeve nga aplikanti tek shitësi;
- k. Vërtetim lëshuar nga Shërbimi Veterinar që konfirmon se ferma bujqësore përbush standartet minimale kombëtare për mirëqenjen e kafshëve;
- l. Vërtetim lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit/Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujëtrave dhe Turizmit konfirmon se ferma bujqësore përbush standartet minimale kombëtare për mbrojtjen e mjedisit;
- m. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare, me firmë dhe vulë të njomë.

Masa 12. Për blerjen e traktorëve, makinerive dhe pajisjeve për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat bujqësore dhe blegtorale.

Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5,000,000 (pesë milion) lekë për subjekt;

i. Kriteret specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Fermer individual, subjekt me status fizik/ juridik, SHBB.

- a. Aplikanti, me status person fizik/juridik, duhet të jetë i regjistruar për fushën e veprimtarisë së pranueshme për të cilën aplikon në Qendrën Kombëtare të Biznesit si dhe me status aktiv;
- b. Në këtë masë mund të aplikojnë fermat të cilat kryejnë aktivitet bujqësor me sipërfaqe minimale toke bujqësore jo më pak se 1 (një) ha si dhe fermat blegtorale me kapacitet jo më pak se 10 (dhjetë) lopë, jo më pak se 100 (njëqind) të imta, jo më pak se 10 (dhjetë) dosa dhe jo më pak se 10,000 (dhjetë mijë) shpendë.
- c. Për investime mbi 5 milion lekë, të ketë plan biznesin e detajuar për 5 vjet, sipas modelit standard, të përcaktuar në Aneksin 11 dhe 11.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi:
 - NPV, duhet të dalë ≥ 0 .
 - IRR duhet të dalë $\geq 1\%$
 - Në rast të informacioneve/dokumentacionit të paqartë/pasakte, AZHBR gëzon të drejtën të kërkojë me shkrim informacion shtesë. Nëse nuk arsyetohen dhe mbështeten informacionet/dokumentacionet me të dhëna faktike të qarta, atëherë ky aplikim skualifikohet.
 - Në rast se nuk plotësohen këto kritere, ose nuk është plotësuar plan biznesi standart sipas Aneksit 11 dhe 11.1, aplikimi skualifikohet;
- d. Toka të jetë në pronësi dhe/ose me qira/ huapërdorje për të paktën 5 vjet, duke filluar nga viti i aplikimit;
- e. Aplikanti nuk duhet jetë debitor ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas legjislacionit në fuqi;

13

- f. Dokumenti i pronësisë së tokës ose qirasë, për të paktën 5 vjet duke filluar nga viti e aplikimit:
 - Certifikata e pronësisë, harta treguese dhe kartela e rifreskuar e pasurisë së paluajtshme (kartela duhet të jetë lëshuar jo më herët se 3 muaj para aplikimit);
 - Vërtetimi i pronësisë shoqëruar me hartën treguese lëshuar nga ASHK (në zonat ku azhormimi nuk ka përfunduar ende ose është në proces);
 - Akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP), sipas legjislacionit për ndarjen e tokës bujqësore, bashkëlidhur me fragmentin e hartës kadastrale, që konfirmon nga ASHK. Nëse AMTP nuk konfirmon nga ASHK, AZHBR kerkon konfirmim zyrtar të këtij dokumenti me sipërfaqen totale dhe sipërfaqen e parcelave nga njesia administrative/bashkia perkatëse.
- Në rastin e dorëzimit të AMTP-së duhet të dorëzohet certifikatë familjare e gjendjes më 1.8.1991 shoqëruar me Formularin tip të dakordësisë së anëtarëve të familjes bujqësore sipas Aneksit 8.1. Marrëveshja duhet të jetë e firmosur nga të gjithë anëtarët sipas gjendjes aktuale. Nëse ka ndryshime midis gjendjes së certifikatës së 1.8.1991 me gjendjen e certifikatës aktuale atëherë marrëveshja duhet të shoqërohet me dokumentacionin plotësues sipas rastit dhe sipas legjislacionit në fuqi. Marrëveshja duhet për një afat të paktën 5 vjet, duke filluar nga viti i aplikimit.

Kur aplikanti merr tokë me qira/huapërdorje :

- Fotokopje e kontratës së transferimit të të drejtave të përdorimit (kontratë qiraje, huapërdorje) me një kohëzgjatje minimale të paktën 5 vjet pas datës së aplikimit, me vërtetim notarial shoqëruar me dokumentacionin e prënësisë;
- Fotokopje e kontratës së qirasë (kontratë/kontratë tip) të lidhur me strukturat publike me një kohëzgjatje minimale të paktën 5 vjet pas datës së aplikimit shoqëruar me dokumentacionin e prënësisë përkatës.

iv. Dokumentacioni dhe kërkesa për financim

Sipas llojit të investimit, aplikanti paraqet pranë AZHBR-së kërkesën për financim. Financimi do të realizohet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Së bashku me kërkesën për financim, aplikanti paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Formularin e kërkesës për pagesë sipas Aneksit 18;
- b) Regjistrin e plotësuar/ përditësuar të fermës;
- c) Faturën/faturat tatimore, shoqëruar me specifikimet teknike të traktorit / makinerive/ pajisjeve dhe vlerën sipas kontratës;
- d) Akt zhdoganimit për traktorë/makineri/pajisje që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën e elementëve përbërës;
- e) Transaksionin bankar, dhe/ose SWIFT-in (për pagesat ndërkombëtare) për të gjitha pagesat, që vërteton transferimin e fondeve nga aplikanti tek shitësi;
- f) Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka përbushur detyrimet. Për fermerët individualë vërtetim për shlyerjen e sigurimeve shoqërore nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë;
- g) Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare, me firmë dhe vulë të njomë.

Masa 13. Mbështetje për akuakulturën detare për koshat e rritjes së peshkut (vetëm për koshat dhe rrjetat). Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 20,000,000 (njëzet milion) lekë për subjekt."

i. Kriteret specifike të përfitimit

15

- f. Aplikanti nuk duhet të jetë debitor ndaj AZHBR dhe MBZHR;
- g. Aplikanti nuk duhet të jetë i dënur me vendim të formës së prerë për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;
- h. Aplikanti nuk duhet të jetë kredimarrës me status 3 dhe/ose 4 sipas Raportit të Kredimarrësit;
- i. Investimi nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës.

ii. Kriteret konkurruese

- | | |
|---|-----------------|
| - Sipërfaqja/ numri i krerëve të kafshëve | 75 pikë |
| - Moshë e aplikantit | 25 pikë |
| TOTALI | 100 pikë |

Vlerësimi i aplikimeve:

Sipërfaqja/ numri i krerëve të kafshëve

Vlerësimin maksimal për sipërfaqen e fiton aplikimi me sipërfaqen/krerët maksimale (20 ha, 50 krerë lopë/ gjedh, 300 krerë të imta dhe 50 dosa), të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me këto shifra.

Aplikimet me sipërfaqe më të vogla se 20 ha/ numër krerësh më të vogël llogariten në mënyrë proporcionale sipas formulës:

$X = \text{Sipërfaqja/krerët për të cilën aplikon (sipërfaqja në dynym/ krerët)} * 75 / \text{sipërfaqen/krerët maksimal (200 dynym/ krerë lopë/ gjedh, 300 krerë të imta dhe 50 dosa)}$.

Moshë e aplikantit (25 pikë):

Marrin 25 pikë aplikantët të cilët në datën e aplikimit janë nën 40 vjeç. Për personat juridikë pikëzimi do të bëhet duke llogaritur moshën e aksionerëve.

Sipërfaqja në ha i referohet tokës në prodhim dhe/ose të kultivuar ndërsa numri i krerëve i referohet numrit faktit të kafshëve të fermës. Sipërfaqja e tokës dhe numri i krerëve të jenë brenda një bashkie.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në AZHBR

- a. Formulari i aplikimit sipas Aneksit 10;
- b. Dokumentin e regjistrimit në QKB që vërteton statusin e aplikantit (subjekt me status fizik, juridik, SHBB), nëse nuk gjenerohet nga sistemi
- c. Plan biznesi i printuar dhe në CD i detajuar për 5 vjet, sipas modelit standard, të përcaktuar në Aneksin 2 dhe 2.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- d. Dëshminë e penaltetit për aplikantët me staus fermer dhe person fizik dhe për aksionerët për aplikantët me status juridik, SHBB;
- e. Raporti i kredimarrësit nga Banka e Shqipërisë/ banka të nivelit të dytë për aplikantët për personin në rastin e fermerit dhe personit fizik dhe në emrin e subjektit në rastet e personave juridikë, SHBB.
- f. 1 ofertë origjinale sipas Aneksit 14, shoqëruar, me datë, firmë dhe vulë për çdo lloj investimi, të shoqëruar me formularin e regjistrimit në QKB (regjistrimi duhet të përfshijë aktivitetin për të cilin do të jepet oferta) dhe vlefshmërinë e ofertës. Nëse projekti i propozuar do të realizohet nga subjekte të ndryshme për komponentë të ndryshëm të investimit, atëherë duhet të dorëzohet nga një ofertë sipas kriterëve të këtij paragrafi, nga secili subjekt për komponentin që do të ofrojë. Ofertuesit nuk duhet të jenë në konflikt interesi me njeri tjetrin dhe me aplikantët;
- g. Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka përbushur detyrimet. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit të aplikimit. Për fermerët individualë vërtetim për shlyerjen e sigurimeve shoqërore nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;

14

Përfituesit e mundshëm: Subjekt me status fizik/ juridik.

Janë të pranueshme investimet në lidhje me mallrat si më poshtë:

1. Kosha notues me diametër 30m

- 1 Tubolar polietileni Ø315mm X 95ml
- 1 Tubolar polietileni Ø 315mm X 98ml
- 2 Tubo polietileni Ø 110mm X 95ml
- Polisterol mbushës
- Aksesore polietileni
- 40 Këmbë mbështetëse polietileni
- 2 Kavo çeliku X 95ml

2. Kosha notues me diametër 19m

- 1 Tubolar polietileni Ø250mm X 60ml
- 1 Tubolar polietileni Ø 250mm X 63ml
- 2 Tubo polietileni Ø 110mm X 61ml
- Polisterol mbushës
- Aksesore polietileni
- 30 Këmbë mbështetëse polietileni
- 2 Kavo çeliku X61ml

3. 2 rrjeta për kosh me syze 14 dhe 22 mm.

- a. Aplikanti duhet të jetë i regjistruar për fushën e veprimtarisë së pranueshme për të cilën aplikon në Qendrën Kombëtare të Biznesit si dhe me status aktiv;
 - b. Për investime mbi 5 milion lekë, të ketë plan biznesin e detajuar për 5 vjet, sipas modelit standard, të përcaktuar në Aneksin 11 dhe 11.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi:
 - NPV, duhet të dalë ≥ 0 .
 - IRR duhet të dalë $\geq 1\%$
 - Në rast të informacioneve/dokumentacionit të paqartë/pasaktë, AZHBR gëzon të drejtën të kërkojë me shkrim informacion shtesë. Nëse nuk arsyetohen dhe mbështeten informacionet/dokumentacionet me të dhëna faktike të qarta, atëherë ky aplikim skualifikohet.
- Në rast se nuk plotësohen këto kritere, ose nuk është plotësuar plan biznesi standard sipas Aneksit 11 dhe 11.1, aplikimi skualifikohet.
- c. Për investimet e përfshira në këtë masë, aplikanti në momentin e lidhjes së kontratës me AZHBR duhet të jetë i pajisur me kontratë me MBZHR për zhvillimin e aktivitetit të akuakulturës dhe koordinatat e fermës duhet të jenë brenda ZPA-së sipas VKM-së Nr. 461/2023 "Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave për zonat e përcaktuara për akuakulturë (ZPA) në Shqipëri";
 - d. Mallrat duhet të jenë të reja;
 - e. Aplikanti nuk duhet jetë debitor ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas legjislacionit në fuqi;
 - f. Aplikanti duhet të jenë debitor ndaj AZHBR dhe MBZHR;
 - g. Aplikanti nuk duhet të jetë i dënur me vendim të formës së prerë për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;
 - h. Aplikanti nuk duhet të jetë kredimarrës me status 3 dhe/ose 4 sipas Raportit të Kredimarrësit;
 - i. Investimi nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës.

16

Skema Kombëtare e Investimeve 2024

ii. Kriteret konkurruese

- Mesatarja e xhiros së 3 viteve të fundit	75 pikë
- Punësimi	15 pikë
- Moshja e aplikantit	10 pikë
TOTALI	100 pikë

Vlerësimi i aplikimeve:

Mesatarja e xhiros se 3 viteve te fundit (75 pikë):

Vlerësimin maksimal 75 pikë e fiton subjekti i cili ka nje mesatare më të lartë te xhiros për 3 vite e fundit.

Aplikimet me mesataren më të vogël se subjekti me mesataren më të lartë llogariten në mënyrë proporcionale sipas formulës:

$$X = \text{Mesatarja e subjektit} * 75 / \text{mesataren më të lartë}.$$

Punësimi (Max 15 pikë):

Përfitojnë 15 pikë subjektet të cilat kanë punësim më të lartë.

Vlerësimin maksimal 15 pikë e fiton subjekti i cili ka punësim më të lartë.

Aplikimet me punësim më të vogël se subjekti me punësim më të lartë llogariten në mënyrë proporcionale sipas formulës:

$$X = \text{Numri i të punësuarve} * 15 / \text{numrin e të punësuarve më të lartë}.$$

Moshja e aplikantit (10 pikë):

Marrin 10 pikë aplikantët të cilët në datën e aplikimit janë nën 40 vjeç. Për personat juridikë pikëzimi do të bëhet duke llogaritur moshën e aksionerëve.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në AZHBR

- Formulari i aplikimit sipas Aneksit 10;
- Dokumentin e regjistrimit në QKB që vërteton statusin e aplikantit (subjekt me status fizik, juridik), nëse nuk gjenerohet nga sistemi;
- Plan biznesi i printuar dhe në CD i detajuar për 5 vjet, sipas modelit standard, të përcaktuar në Aneksin 11 dhe 11.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- Dëshminë e penalitetit për aplikantët me status person fizik dhe për aksionerët për aplikantët me status juridik;
- Kontrata e lidhur me MBZHR për zhvillimin e aktivitetit të akuakultures deri në momentin e lidhjes së kontratës;
- Raporti i kredimarrësit nga Banka e Shqipërisë/ banka të nivelit të dytë për aplikantin për personin në rastin e personit fizik dhe në emrin e subjektit në rastet e personave juridikë;
- I ofertë origjinale shoqëruar, me datë, firmë dhe vulë për çdo lloj investimi, të shoqëruar me formularin e regjistrimit në QKB (regjistrimi duhet të përfshijë aktivitetin për të cilin do të jepet oferta) dhe vlefshmërinë e ofertës. Nëse projekti i propozuar do të realizohet nga subjekte të ndryshme për komponentë të ndryshëm të investimit, atëherë duhet të dorëzohet nga një ofertë sipas kriterëve të këtij paragrafi, nga secili subjekt për komponentin që do të ofrojë. Ofertuesi/t nuk duhet të jetë/jenë në konflikt interesi me njeri tjetrin dhe me aplikantin;
- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit të aplikimit.

iv. Dokumentacioni dhe kërkesa për financim

17

- Për aplikantët e renditur mbi vijën, referuar tavaneve të financimit bëhet **kontrolli praparak në terren**, dhe nëse rezultojnë në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim, AZHBR lidh kontratën përkatëse dhe shpall **listën e fituesve**.
- Në kontratën që AZHBR do të nënshkruajë me aplikantin fitues, duhet të përcaktohen qartë penalitetet në rastet kur përfituesi i fondeve të masave mbështetëse nuk pranon të kontrollohet prej inspektorëve të AZHBR-së.
- Grupi i kontrollit në terren bën verifikimin në vend të aplikimit, duke lajmëruar paraprakisht aplikantin për praninë e tij ose të përfaqësuesit ligjor të pajisur me prokurë.
- Grupi i kontrollit në prani të aplikantëve ose të përfaqësuesit ligjor, kryen verifikimet e nevojshme dhe plotëson raportin e verifikimit sipas masës përkatëse. Raporti i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij ligjor dhe gjithë grupi i verifikimit. Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.
- Për masën 13, përveç parashikimeve të mësipërme, për kontrollin dhe vlerësimin e aplikimeve ngrihet Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve (KVA) me urdhër të Drejtorit të AZHBR me përbërje 4 përfaqësues nga AZHBR-ja ku njëri prej të cilëve caktohet kryetar, dhe 1 përfaqësues nga MBZHR/Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.
- Mënyra dhe funksionimi i punës së Komisionit, kontrollit në terren, autorizimit të pagesës, ekzekutimit të pagesës dhe monitorimit, do të përshkruhet në manualin e procedurave të KVA.
- Projektet për masat e investimeve monitorohen 5 (pesë) vite nga pagesa e fundit e AZHBR.
- AZHBR gjatë procesit të aplikimit, përzgjedhjes, verifikimit dhe ekzekutimit të pagesave për çështje që nuk kanë një rregullim të posaçëm në vendimmarrje zbaton parimet:
 - Trajtim të barabartë të aplikimeve, dhe
 - Parimin e proporcionalitetit.

Lëvizja e vizës së financimit dhe rialokimi i fondeve

- Nëse nga "kontrolli administrativ" dhe "Kontrolli në terren", rezultojnë aplikime të refuzuara nga AZHBR për mosplotësim të kriterëve të përfitimit apo moskryerje të investimit, bëhet plotësimi i fondit më fitues të tjerë të masës nga aplikantët e radhës;
 - Për projektet e skualifikuara nga kontrollet administrative dhe në terren, AZHBR njofton aplikantët duke bashkëngjitur edhe arsyen e skualifikimit."
9. Ne kreun IX. "KONTROLLI PËR ADMINISTRIMIN E FONDIT DHE ÇËSHTJE TË TJERA":
- Pika 2 zëvendësohet me formulimin e mëposhtëm:

"AZHBR gëzon të drejtën për të kërkuar çdo informacion /dokumentacion shtesë, në rast se e gjykon të arsyeshme brenda kriterëve dhe procedurave të miratuara në "Manualin e procedurave për implementimin e investimeve të Masave 9 - 12" dhe në "Manualin e procedurave për implementimin e Masës 13".
 - Pika 10 zëvendësohet me formulimin e mëposhtëm:

I. "Aplikimi, kontrolli administrativ, verifikimi në terren, autorizimi, ekzekutimi i pagesës dhe monitorimi i aplikimeve përshkruhen në "Manualin e procedurave për implementimin e investimeve të Masave 9 - 12" dhe në "Manualin e procedurave për implementimin e Masës 13", të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme të AZHBR-së".
- iii. Pas pikës 14, shtohet pika 14/1 me formulimin e mëposhtëm:

19

Sipas llojit të investimit, aplikanti paraqet pranë AZHBR-së kërkesën për financim. Financimi do të realizohet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Së bashku me kërkesën për financim, aplikanti paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formularin e kërkesës për pagesë sipas Ankesit 19;
- Faturën/faturat tatimore, shoqëruar me specifikimet teknike të mallrave me vlerën sipas kontratës;
- Akt zhdoganimin për mallrat/pajisjet që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën e elementëve përbërës;
- Transaksionin bankar, dhe/ose SWIFT-in (për pagesat ndërkombëtare) për të gjitha pagesat, që vërteton transferimin e fondeve nga aplikanti tek shitësi;
- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet koherente të kontributeve shoqërore, shëndetësore, etj. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë;
- Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare, me firmë dhe vulë të njomë.

8. Pas Kreut VIII/I shtohet Kreu VIII/II me formulimin si më poshtë vijon:

"VIII/II. PROCEDURAT E APLIKIMIT, PËRZGJEDHJES, VERIFIKIMIT DHE EKZEKUTIMIT TË PAGESAVE PËR MASAT 9-13

- AZHBR, nëpërmjet Zyrës së Protokollit, pranon dosjet e aplikimit me dokumentacionin përkatës dhe plotëson formularin e pranimit. Një kopje e këtij formulari i jepet aplikantit.
- Dosja e aplikimit duhet të përmbajë të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas masës mbështetëse.
- Në rastin kur aplikanti gjendet në një nga situatat e përmendura si më poshtë, aplikimi do të refuzohet menjëherë.

Mangësi skualifikuese në procesin e aplikimit, janë si më poshtë:

- Mungesa e plotë e planit të biznesit, sipas përcaktimeve në secilën nga masat përkatëse;
 - Mungesa e të gjithë dokumentacionit mbështetës;
 - Mungesa e ofertës;
 - Ofertuesit janë në konflikt interesi me aplikantin;
 - Paraqitja e dokumenteve/deklarimeve të rreme.
- Aplikantët informohen zyrtarisht lidhur me mangësitë në dokumentacion të administruar në dosjen e aplikimit, dhe u lihet një afat 10 ditë pune nga marrja e njoftimit për dorëzimin e tyre. Plotësimi i dokumentacionit të dosjes nuk mund zgjasë përtej 45 ditëve kalendarike nga afati i përfundimit të aplikimeve.
 - Dorëzimi i dokumenteve përtej afatit 45 ditë kalendarike nga afati i përfundimit të aplikimeve, është kriter skualifikimi (me përjashtim të dokumentit të lejes së ndërtimit/miratim i deklaratës paraprake/ kontratës së lidhur me MBZHR për zhvillimin e aktivitetit të akuakultures për masën 13, e cila duhet të paraqitet para lidhjes së kontratës).
 - Mbas plotësimin të dosjes, bëhet vlerësimi për përputhshmërinë e kriterëve për çdo masë mbështetëse.
 - Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Për aplikimet me pikë të barabarta, zbatohet parimi "Kush vjen i pari renditet i pari".

18

"Pika 14/1. Për masat mbështetëse 9-12, në rastet kur ndryshimi i sipërfaqes/nr. krerëve/vlerës së deklaruar në aplikim me sipërfaqen/nr e krerëve/vlerën e realizuar ka diferencë, do të aplikohen penalitetet si më poshtë:

- Në rastin kur ndryshimi i sipërfaqes/nr të krerëve/vlerës së deklaruar në aplikim me sipërfaqen/nr e krerëve/vlerën e realizuar është mbi 10 % deri në 20 % aplikimit i zbritet 50 % nga pagesa e grantit;
- Në rastin kur ndryshimi i sipërfaqes/nr të krerëve/vlerës së deklaruar në aplikim me sipërfaqen/nr e krerëve/vlerën e realizuar është mbi 20%, aplikimi do të skualifikohet.

Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Ministria e Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe Ministria e Financës.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL



MINISTRI I FINANCAVE



20

Kredi Agrobiznes 

A mund të blej makineri dhe
pajisje të reja bujqësore?

*SIGURISHT,
BËHET!*



 **CREDINS bank**

www.bankacredins.com

Tel.: +355 4 53 53 000

